



**KJO FË ËSHTË JETA,
PËR KREJT NE
DHE NJERËZIMIN..!**



TË KAM PREMTUAR...



E PARA, DITURIA!

Viti 16 - Nr. 9 (187),
Shtator, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

Lexo,

me emrin e Zotit tënd!

Falënderimet i takojnë All-llahut të Madhëruar që e bëri dijen dhe lartësimin në shkallët e saj mënyrë prej mënyrave të afrimit me dashninë e Tij, kur tha: "All-llahu i lartëson ata që besuan prej jush dhe i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri."

Nga këtu, më lejoni që në këtë të xhuma të parë të vitit të ri 1440 dhe në prag të fillimit të vitit të ri të dijes dhe dijetarëve, mësuesve dhe nxënësve të dijes, të uroj me zemër Mësuesit tanë, edukatorët e nderuar dhe të bekuar në Kur'anin Famëlartë dhe në lutjet e pejgamberit (a.s); sikurse lutem me zemër për fëmijët dhe rininë tonë, në këtë sezon të ri të rifillimit të një viti plot sakrificë e përkushtim: All-llahu jua lehtësoftë këtë rrugëtim, që shpie drejt xhenneteve! All-llahu jua lehtësoftë këtë rrugëtim të ri të vështirë, por të mbushur me kënaqësinë e kërkimit dhe thellimit në dije, me anën e së cilës All-llahu na dalloj nga krejt krijesat e tjera!

I mjafton krenari e lavd,

Mësuesit dhe Dijetarit, si personazh i nderuar në jetën tonë, fakti që All-llahu i Madhëruar e ka bërë shkallën e dijes mjet krahasimi i shkallës së vlerave në jetë, deri në ditën e gjykimit. Thotë: "Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim"

Pastaj, të nderuar mësues të vlerave dhe lartësimit tonë në këtë botë dhe udhërrëfyes për ne drejt bekimeve të jetës së ardhshme, lum si ju, pastaj lum si ju, sepse Resulull-llahu (a.s.) tha: "Më i miri i njerëzve është besimtari i DITUR (el-mumin el-alim), i cili kur të tjerët kanë nevojë për të, sjell dobi dhe kur të tjerët e lënë pas dore, i sjell dobi vetvetes!"

Dhe dijeni se sa shumë e ka lartësuar i Dërguari i Islamit dijen, sa ka thënë: "Besimi është i zhveshur; përkushtimi janë rrobat e tij, turpi është bukuria e tij, frutet e tij janë dituria!"

*(Nga hytbeja e Myftiut,
Imam Muhamed Sytari,
me rastin e fillimit të vitit të ri
shkollor, 2018-2019)*



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

KJO FÉ ËSHTË JETA, PËR KREJT NE DHE NJERËZIMIN..!

Kjo fé është Feja, përtej fjalëve të shumta e përtej propagandave të njërës a tjetrit; përtej shoqatave-“fé” a “feve”-shoqata; aktrimeve mediatike a jargavitjeve politike; përtej krizave institucionale a delireve mbytëse, që fiken sapo mbyllet një burim a ndizen kur hapet një tjetër!?

Kjo fé është fé e njerzillekut, fé e mëshirës, fé e dashnisë së pastër, fé e zemrës së dlirtë, fé e drejtësisë, fé e mendjes së pjekur, fé e çlirimit nga komplekset e idhujtarisë, fé e ndriçimit të zemrës dhe qetësisë të saj me dritën e përmendjes së vazhdueshme të të Vetmit Zot, që është i Gjallë e nuk vdes, që nuk ka të ngjashëm, që është i Përherëshëm pa fillim, i Përherëshëm pa mbarim, për të cilin dëshmojnë argumentet logjike, para atyre teologjike!

Kjo fé është feja e moralit, që sot është përdhosur e flakur tutje edhe në altaret e propagandave mbytëse të dritës së mendjes e ndriçimit të zemrës në emër të idhujve modernë!?

Kjo fé është feja e familjes, ku Baba dhe Nana qëndrojnë në piedestalet më të larta të një bote të nurtë, ku pas adhurimit të Zotit renditet respekti dhe përulja ndaj Prindërve, deri në atë gradë sa jemi ndaluar t’u themi edhe “uf”, teksa jashtë kësaj bote, prindi edhe poshtërohet, edhe lihet pas dore, edhe hidhet në azil, edhe përçmohet,

edhe vritet..!?

Kjo fé është feja e dijes, ku dijetarët krahasohen me të dërguarit e Zotit, ku dija peshohet me florinj, ku për dijetarin kërkon falje çdokush në këtë ekzistencë e, ku dijetarët vijnë të tretët, pas Zotit dhe melekëve të Tij, në shkallën e Dëshmive të mëdha për mbarë botën!

Kjo fé është feja e dashnisë për tjetrin atë që duhet për veten; e dashnisë së udhëzimit për të ardhshmin e për tjetrin deri në gradën e lutjes: “All-llahumme udhëzoje popullin tim se nuk dijnë!”, kur të kanë gjuajtur e refuzuar me përbuzje e fyrrje mesquine; e dashnisë që të bën më të dashurin e krijesave të Zotit tek Zoti, teksa mundohesh me dashni të ndihmohesh e të përkrahësh dikë prej krijesave të Tij, kushdo qoftë ajo krijesë!

Kjo fé.., nuk ka nevojë për mua as për ty! Kjo fé është Jeta, për krejt ne dhe Njerëzimin, sidomos në kohëra kur mjegulla e idhujtarisë, hipokrizisë dhe krizave të identitetit, është lartësuar deri në kupë të qiellit, është shitur për pak famë e është blerë për pak mashtrim të egos së zhytur në batakun e pavetëdijes dhe mungesës së udhëzimit, drita e të cilit, gjithësesi është vetëm në dorën e Poseduesit të saj!

Dyert e alternativave islame janë të hapura për pendim e kthim, o populli im!

Shkodër, 25 shtator 2018

*Dyert e alternativave islame
janë të hapura
për pendim e kthim, o populli im!*

Në suren “El-Enbija”, All-llahu i Madhëruar përmend edhe Hz. Zekerijain (a.s.) dhe familjen e tij të nderuar. Ndër të tjera përmend një prej cilësive të spikatura të kësaj familjeje besimtare dhe të përkushtuar ndaj Fjalës së Zotit dhe Thirrjes së Tij. Thotë për ta: “Ata nxitonin për vepra të mira...” – (El-Enbija: 90).

Ndërkohë, në suren e Pendimit, teksa përjetëson shembullin e mirë të sahabëve të ndershëm dhe vullnetin e tyre për ndërtimin e një xhamie të ngritur nga sinqeriteti, pastërtia dhe përkushtimi në rrugën e All-llahut, Zoti i gjithësisë na frymëzon me një shembull të mrekullueshëm, për të cilin thotë: “Një xhami e cila që prej ditës së parë është themeluar në respekt ndaj All-llahut (pa hile), është më e drejtë të falesh në të, aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen mirë, e All-llahu i do të pastrit!” – (Et-Teube: 108).

All-llahu ekber! Sot, më 15 shtator 2018, duke u gdhirë data 16 e këtij muaji vjeshte, në Sulgen të Zvicrës, ca BURRA, prej atyre: “që dëshirojnë të pastrohen”, shkruan me përkushtimin dhe dashninë e tyre preludin e PRANVERËS më të bukur të shqiptarëve të atij vendi të begatë, duke na bërë të ndjehemi krenarë, sot e deri në ditën e gjykimit!

Nën drejtimin e Hoxhës së zemrave dhe vizionarit të shquar islam të trojeve tona, Hoxhë Ahmed Mehmedi, vëllezërit e mi të shtrenjtë të xhamisë “Buhara” të Kradolfit, shkruan sot, me përkushtimin e zemrave të tyre kapitullin më të bukur në historinë e rimëkëmbjes së madhe të kësaj Thirrjeje të Madhueshme Islame, atje larg, në zemër të Evropës!

Është e paimagjinueshme shuma prej 1 milion e 184 mijë frangave zvicerane, që u mbledhën në një thirrje prej rreth tre orësh, për ndërtimin e një xhamie të re

“ATA NXITONIN PËR VEPRA TË MIRA...”

“Një xhami e cila që prej ditës së parë është themeluar në respekt ndaj All-llahut (pa hile), është më e drejtë të falesh në të, aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen mirë, e All-llahu i do të pastrit!” – (Et-Teube: 108).

në një tokë, njerëzit dhe institucionet e së cilës ia kanë hapur dyert e zemrës dhe mirëkuptimit shqiptarëve të shtrenjtë, muslimanëve të përkushtuar, ndërtuesve të së mirës, mbrojtësve të paqes e harmonisë, përçuesve më të denjë të shembullit konkret të qytetarëve model, me besim në All-llahun e Madhëruar, udhëzimin kur’anor e dritën e traditave të Hz. Muhammed Mustafasë!

Ajo çfarë këta BURRA të Islamit kanë bërë sonte, është një jehonë e begatë mirësie dhe krenarie legjitime, që vjen nga zemra e kontinentit tonë për ne shqiptarët, kudo që të jemi, por edhe për mbarë botën islame!

Është jehona e pastër e sihariqit të Resulull-llahut (a.s.), kur thoshte, këtu e 15 shekuj më parë: “Do të mbërrijë kjo fé, ku ka mbërritur nata dhe dita!”, që me fjalë të tjera përkthehet edhe si një thirrje frymëzuese, që na nxit, si për të na thënë: “Ngrihuni o pasues të Thirrjes së lashtë të Zotit të botëve, në çdo kohë e në çdo vend, vishuni me virtytet e fesë tuaj, mbrojeni me dinjitet identitetin tuaj, hapjani zemrat njerëzve, kushdo qofshin, dëshironi për ta, atë që doni për veten tuaj, lutuni për të mirën dhe përhapeni atë, ndërtoni ura harmonie dhe komunikimi ndërnjerëzor dhe lajmëroni me të madhe se All-llahu i do të pastrit!

Mos u tundoni para paragjykitimit e keqleximit që ju bëhet, punoni dhe sakrifkoni, bashkohuni dhe mos u përçani, kapërceni situatat me

bashkëpunim dhe lidhje të ngushtë në mes vete, që të fitoni bekimet dhe mëshirën e Zotit të botëve!.”

Ata nuk bënë asgjë më shumë se iu përgjigjën thirrjes së Resulull-llahut (a.s.): “Përhapni për mua, qoftë edhe një fjalë” dhe fjala e tyre sonte ishte bashkimi dhe dashnia për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij!

Ata sonte dëshmuan se vrapimi drejt mirësive nuk ka limit, nuk njehe kufi, nuk ka pengesë dhe e ka rrugën e hapur deri në kijamet, kur në krye të punëve është sinqeriteti, përkushtimi dhe dorëzimi pa kushte para duarve të Atij, që urdhëron në Kur’anin Famalartë: “Vërtetë xhamitë i janë kushtuar vetëm All-llahut...” – (El-Xhin: 18).

Ata sonte dëshmuan para të gjithëve ne se, punët e mëdha bëhen nga BURRA të mëdhenj, jo ndryshe..!

Ata sonte bënë mrekullinë e besimit në një kohë sprovash dhe mjegullnajash, ku Drita e Besimit dhe Madhështia e Islamit në zemrat e sinqerta vezullon, duke larguar çdo hije e duke dhuruar ngrohtësi e bekim!

Sonte qyteza e Sulgenit u ndriçua dhe mori bekim, që do të shpërndahet ndër krejt banorët e saj, si një mirësi e madhe e bashkëqytetarëve të tyre të ndershëm e fisnikë me prejardhje nga toka e bekuar shqiptare!

Sonte të gjithë ne kemi Bajram, atë të vëllezërve tanë të xhamisë “Buhara” të Kradolfit e Sulgenit!

Me këtë rast, uroj përzemërsisht vëllanë e dashur, H. Mustafa Saliu, Kryetar i xhamisë së “Buhara-së”, imamin e xhamisë, Hoxhë Ahmed Mehmedi dhe krejt vëllezërit e mi të Forumit të Rinjve Muslimanë dhe pjestarët e xhematit të nderuar të kësaj xhamie dhe këtij komuniteti të madh vlerash!

All-llahumme dëshmo për këta BURRA, që vërtetuan sonte, jo për sy e faqe se, janë prej atyre, që meritojnë nderin e dëshmisë së madhe: “Ata nxitonin për vepra të mira...”.

Me zemër dhe mirënjohje!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, më 16 shtator 2018





Arben Halluni, teolog

Feja Islame i ka kushtuar një rëndësi të veçantë diturisë, ka nxitur dhe nxit vazhdimisht ymetin drejt kërkimit të diturisë e përdorimit të logjikës. Islami kërkon hulumtim dhe mendim në çdo sferë të dijës e të shkencës dhe në çdo lëmi që përfshin bota lëndore, sepse dituria është boshti i jetës, themeli i progreseve, shtylla e civilizimeve dhe mënyrë e integritetit të individëve dhe shoqërive.

Nuk ka dyshim se Islami është feja e jetës së shëndoshë në çdo kohë e vend. Islami është shpirt dhe materie, adhurim dhe jetë dhe nuk kufizohet vetëm në adhurim e asketizëm dhe lidhje të njeriut me botën e përtejme, por është fe gjithëpërfshirëse, lidh njeriun me vlerat, moralin dhe adhurimin, depërton në thellësi të jetës dhe vendos baza, të cilat garantojnë lumturinë e të gjithë njerëzve në çdo pëllëmbë të tokës.

Ligjislacioni islam është i ngritur në sajë të diturisë dhe mbi të mbështetet çdo çështje nga çështjet e fesë e të jetës. Mrekullia e të Dërguarit të Islamit ishte Libri hyjnor që ndrit me dije të vërtetë dhe me njohuri reale. Tashmë dihet se ajeti i parë që zbriti tek i Dërguari i Fundit, Muhammedi (a.s) ishte thirrja për t'u pajisur me dituri, për të shenjtëruar njohurinë. Për të arritur në shkallën e njohurisë dhe të dijës i duhet kushtuar vëmendje në mënyrë të shkallëzuar shkrimi e leximit. Në këtë kontekst në Kur'anin famëlartë thuhet: “Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujar! Ai që mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte”. - (El-Alak: 1-5). Gjithnjë rreth kësaj vlere Allahu (xh.sh) betohet në pendën: “Nun! Betohem në penën dhe në atë çka shkruajnë”. - (El-Kalem: 1)

Nga ana tjetër Krijuesi i gjithësisë e ka dalluar njeriun nga të gjitha krijesat

E PARA, DITURIA!

me dituri. Po të pajiset njeriu qoftë edhe me një sasi të vogël dije arrin të dallohet nga krijesat tjera. Dituria është një nga veçoritë kryesore të njeriut. Është pikërisht dituria që e bëri njeriun të jetë në shkallë më të lartë se melekët. Sipas Kur'anit mësojmë se Allahu (xh.sh) i urdhëroi melekët, krijesat më të nderuara, t'i bëjnë sexhde Ademit, njeriut, babait dhe profetit të parë të njerëzimit, për shkak se ishte më i privilegjuar se engjëjt në dije e njohuri.

“E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve), pastaj ato ua prezantoi engjëjve dhe u tha: “Më tregoni për emrat e këtyre (sendeve të emëruara), nëse jeni të drejtë (çka mendoni)? (Engjëjt) Thanë: Ti je i pa të meta, ne nuk kemi dije tjetër, përveç atë që na e mësove Ti. Vërtet, Ti je i Gjithdijshmi, i Urti. (Zoti) tha: O Adem, njoftojë ata (engjëjt) me emrat e atyre (sendeve)! E kur u rrëfeu atyre për emrat e tyre, (Zoti) tha: A nuk u kam thënë juve se Unë, më së miri e di fshehtësinë e qiejve e të tokës dhe më së miri e di atë, që ju e publikoni dhe atë që e mbani fshehtë. E kur u thamë engjëjve: përluni(bini sexhde) Ademit, ata menjëherë iu përlunë, me përjashtim të iblisit (djallit)...”. - (El-Bekare: 31-34)

I Dërguari i Fundit, Muhammedi (a.s) ishte shëmbëlltyra e thirrësve për sa i përket diturisë me fjalë dhe me vepra, saqë e bëri kërkimin e dijës detyrim për çdo individ në mënyrë që besimi, adhurimi dhe çështjet e jetës të jenë sipas rregullit hyjnor. Pikërisht për këtë Profeti i Islamit, transmetuar nga Ibn Maxheh, ka thënë: “Kërkimi i diturisë është obligim për çdo mysliman dhe myslimane”. Në fjalët profetike që ka lënë i Dërguari i Fundit rreth kërkimit të dijës vihet në dukje nderi dhe shpërblimi që i pret ata që i kushtohen diturisë: “Melekët hapin krahët e tyre për kërkuesin e diturisë si shpërblim për çka veprojnë”. Po ashtu, Zotëria ynë në një hadith tjetër fisnik, përcjellë nga Muslimi ka thënë: “Kush vijon udhën e dijës, Allahu (xh.sh) do t'ia lehtësojë atij rrugën për në xhenet”.

Këto janë disa nga fjalët e Profetit të Islamit për diturinë, ndërsa nga veprat e tij mund të përmendim rastin e luftës së Bedrit, ku ai liroi disa robër të ditur për t'ua mësuar një grupi myslimanësh leximin dhe shkrimin. Thirrja e tij për t'u pajisur me armën e dijës nuk ka qenë e përqendruar vetëm te burrat, por te burrat e gratë.

Në këtë rrugë të nderuar profetike

kanë ecur edhe sahabet, tabiinët dhe selefët e nderuar, të cilët brez pas brezi kanë përcjellë thirrjen për dituri. Abdulmelik ibn Mervan i ka thënë të birit të tij: “O biri im, kushtoj diturisë, nëse je prej zotërinjve do të jesh superior e do të lësh të tjerët pas vete, nëse je prej të mesmëve do të bëhesh prej udhëheqësve dhe nëse je prej popullit të thjeshtë do të bëhesh prej atyre që vetëm jetojnë”. Me pak fjalë, kuptojmë prej fjalëve të lartpërmendura se njeriu sa më shumë të shkallëzojë diturinë aq më shumë vlerësohet e zë vend të nderuar. Një popull që nuk i jep rëndësi dijës së frytshme në çdo lëmi nga lëmit e kësaj jete nuk ka vend midis popujve të tjerë. Konkurrimi dhe vënia në garë e popujve të ndryshëm në sferën e

**ISLAMI KËRKON
HULUMTIM DHE MENDIM
NË ÇDO SFERË
TË DIJES E TË SHKENCËS
DHE NË ÇDO LËMI QË
PËRFSHIN BOTA LËNDORE,
SEPSE DITURIA ËSHTË
BOSHTI I JETËS...**

diturisë bashkëkohore është sa e fortë aq edhe e ashpër, çka mund t'i bëjë popujt e prapambetur që nuk lidhen pas shkaqeve të civilizimit më të dobët dhe më të plogësht. Përpara këtij realiteti feja islame i bën thirrje si gjithmonë ymetit të vet dhe njëkohësisht e nxit të garojë në çdo aspekt, duke e paralajmëruar se po të veprohet e kundërta mund të humbasë e të vonohet si ymet në shumë çështje jetësore, sidomos në kohën aktuale të teknologjisë e të zhvillimit të shpejtë. Në lidhje me këtë në Kur'an thuhet: “Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë”? Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim”. - (Ez-Zumer:10).

Jo vetëm kaq por, Allahu (xh.sh) u ka kërkuar njerëzve që të hedhin shikimin e tyre në univers dhe në çdo gjë që gjendet në të, me qëllim që të njihen me sekretet e tij dhe për të përfutur nga thesaret që përmban kjo gjithësi. Pra, kjo botë e krijuar në mënyrë precize dhe me gjithë këtë rregull është një mundësi e mirë për t'u studiuar e për të nxjerrë

konkluzione të sakta rreth të Vërtetës nga hulumtuesit, dijetarët dhe shkencëtarët. “A nuk e dini ju, se Allahu nënshtroi për të mirën tuaj ç'ka në qiej e ç'ka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta”. - (Llukman: 20) Pra, krijimi qiejve dhe i tokës me të gjitha dukuritë dhe fenomenet në to, janë argument i fuqisë së pakufishme të Zotit një. Po të ketë një hulumtim serioz pa dyshim se do të arrihet të kuptohet e të besohet në Krijuesin e gjithësisë.

Feja islame është feja që është ngritur mbi diturinë në çështjet besimore dhe në çështjet e sheriatit. Besimi monoteist që e pranon Allahu (xh.sh) është ai besim që ngrihet mbi dituri. “Atëherë, dije se nuk ka Zot tjetër pos Allahut”. - (Muhammed: 19)

Në Kur'anin famëlartë bëhet e ditur se dijetarët dhe melekët do të jenë ata të cilët dëshmojnë për Allahun Një. “Allahu vërtetoi se nuk ka Zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe melekët e dijetarët. Dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot, përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit”. - (Ali Imran: 18)

Një fe që mbështetet mbi diturinë, siç është Islami, e konsideron atë që ndjek dijen në çdo kohë e në çdo vend (aq më mirë kur e zbaton atë në jetë) nga adhuresit më madhështorë. Profeti Muhammed (a.s) në një hadith të tij fisnik, transmetuar nga Taberaniu, thotë: “Dituria e pakët është më e mirë se adhurimi i shumtë”. Një adhurim që nuk ka për bazë diturinë, as nga Libri i shenjtë e as nga suneti profetik nuk mund të sjellë ndonjë të mirë apo vlerë përfutuese. Kjo logjikë mbështetet në këto fjalë të të Dërguarit të Islamit, i cili ka thënë: “Një fakir (dijetar i sheriatit) është më i fortë mbi shejtanin (djallin e mallkuar) se një mijë adhures”. - (Transmetuar nga Tirmidhiu)

Njerëzit që kërkuar dijen dhe e zbatuan atë, shpëtuan nga injoranca. Jo vetëm kaq, por Islami në të gjitha periudhat e kohët e njerëzimit ka inkurajuar njerëzit e dijës dhe ka përkrahur iniciativat e tyre për zbulime shkencore. Ja si e paraqet Kur'an famëlartë këtë realitet: “E ata që ishin të zotët e diturisë thanë: “Të mjerët ju, shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepër të mirë, po atë nuk mund ta arrijë kush përveç të durueshmëve!” - (El-Kasas: 80)

Nga ana tjetër Islami fton që në udhëtimin e kërkimit të diturisë të ketë një grup që t'i kushtohet hulumtimit dhe studimit të çështjeve dhe lëmive. Kjo ftesë mbështetet në fjalët e Allahut (xh.sh) të shprehur në Kur'anin famëlartë:



“E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t'u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ata, në mënyrë që ata ta kuptojnë (e të ruhen)”. - (Et-Tevbe:122)

Pejgamberët në përgjithësi duke mos pasur dituri të mjaftueshme dhe njohuri të konsiderueshme udhëtonin për të kërkuar sa më shumë dije, megjithëse ata ishin të pajisur me mësimet hyjnore. Allahu (xh.sh) i thotë të Dërguarit të Tij, Muhammed (a.s): “Thuaj: Zoti im, më shto dituri”. - (Taha:114)

Sipas tregimeve kur'anore, një herë Musaj (a.s) dëgjoi se në gjithësi është një njeri më i ditur se ai. Pikërisht për këtë udhëtoi gjatë deri sa arriti ta takojë. Mirëpo, njeriu i ditur kërkoi prej Musait (a.s) që dijen ta kërkojë me sjellje të hijshme dhe me durim. Shkurtimisht, ja si e përshkruan Kur'an famëlartë: “Atij (Hidrit – njeriut të mirë e të dijshtëm) Musai i tha: A pranon të vij me ty, që të më mësosh nga ajo që je i mësuar (i dhuruar) ti: dituri të drejtë e të vërtetë? Ai (Hidri) tha: Sigurisht, ti nuk do të mund të kesh durim me mua! Si do të durosh për atë që nuk je i njoftuar? (Musai)Tha: Në dashtë Allahu, do të shohësh se do të jem i durueshëm dhe nuk do të kundërshtoj ty për asgjë!”- (Kehf: 66-69)

Kur isha student në vitin e dytë të fakultetit teologjik, dega “Besim dhe Filozofi”, pranë universitetit më të vjetër në botë “Al-Az'her”, në Kajro, ndodhi një herë në orën e fikut (jurisprudenca islame) një ngjarje interesante. Në kohën që profesori i lëndës ishte duke shpjeguar një temë prej temave të lëndës, filloi të thirrej ezani i namazit të drekës. Dy prej studentëve në sallë kërkuar leje për të shkuar në xhami për t'u falur. Profesori nuk u dha leje. Dy studentët të habitur thanë: “Përse, a është vakti i kryerjes së namazit?”. Profesori u

përgjigj në këtë mënyrë: “Shikoni, në këtë moment jemi para dy obligimeve, diturisë që është obligim duke u bazuar, se profeti Muhammed ka thënë: “Kërkimi i diturisë është obligim për çdo mysliman e myslimane” dhe faljes së namazit, që edhe ai është obligim, duke u mbështetur në fjalët e Allahut (xh.sh) në Kur'an: “Fale namazin...”. Atëherë si duhet të veprojmë? Në këtë rast duhet të përdorim logjikën, që vlerësohet shumë nga feja jonë. Logjika thotë që të shohim, se cili nga këto dy obligime ka filluar i pari në kohë. Jemi dëshmitarë se kemi filluar me diturinë. Kështu që diturisë do t'i japim prioritet dhe pastaj ta falim namazin e drekës bashkërisht dhe me kusht që të kryhet në kohën e vet.

Pra kjo është madhështia e Islamit që jep zgjidhje për çdo çështje, në çdo kohë dhe mbi çdo situatë. Me të drejtë deklarojnë njerëzit e mëdhenj të dijës, shkencës, artit, kulturës e filozofisë se besimi islam është alternativë për mbarë njerëzimin.

I Dërguari i Fundit, Muhamedi (a.s), ka porositur njerëzit që të ndjekin dijetarët, të dëgjojnë prej tyre dhe të praktikojnë çdo parim kur'anor e këshillë profetike që del prej tyre dhe njëkohësisht të mësojnë çka iu sjell dobi. Janë të porositur edhe dijetarët islamë që të mësojnë njerëzit me frymën e urtësisë dhe të paqes në mes krijesave. Në këtë pikëpamje Profeti i Islamit thotë në një hadith të tij të përcjellë nga Taberaniu: “Lakmitarë që nuk ngopen janë kërkuesi i diturisë dhe kërkuesi i pasurisë”.

Duke e përfunduar trajtimin e kësaj çështjeje dua të ftoj të gjithë besimtarët që të kërkojnë diturinë në të gjitha fazat e moshës së tyre, sepse me dije njeriu bëhet besimtar, adhures i denjë dhe i moralshëm në çdo pikëpamje. Ftoj sidomos prindërit që me mundësitë e tyre të investojnë për fëmijët që të shkollohen lart e më lart. Një pjesë të tyre t'i dërgojnë edhe në shkolla fetare, siç janë medresetë, mejtepet (kurset fetare) pranë xhamive me qëllim që me anë të teologëve dhe hoxhallarëve të marrin kulturë të përgjithshme islame, njohuri rreth besimit të tyre dhe aq më shumë të pajisen me edukatën fetare që padyshim do t'u vlejë në të gjitha kohërat që të bëhen besimtarë të devotshëm dhe paqësor me të gjithë.

Një herë është pyetur një njeri i arsimuar dhe i edukuar: “Pse i nderoni dijetarët kaq shumë?”, Ai është përgjigjur: “Allahu bëri sebeb (shkak) prindërit e mi që të më zbrasin nga qielli në tokë dhe bëri sebeb dijetarët që të më ngjisin nga toka në qiell”.

PALESTINA ISLAME

Në vitin 633, kalifi Ebu Bekr Es-Siddik (r.a), dërgoi disa njësi ushtarake, nën udhëheqjen e Amr ibnul-Asit, Jezid ibn Ebi Sufjanit, Sharhabil ibn Hasene dhe Ebu Ubejde ibnul-Xherrah, për të çliruar tokat e Palestinës dhe Sirisë. Jezidi (r.a), i mundi romakët në Luginën Arabe, në jug të Detit të Vdekur, duke i zbrapsur ata deri në Gaza, në vitin 634.

kusht që qytetin e Kudsit t'ia dorëzonte personalisht Prijësit të besimtarëve, kalifit Umer ibnul-Hattabit (r.a). Qyteti i Kudsit në atë kohë quhej "Il'ja".

Umeri (r.a), erdhi në Palestinë, në përgjigje të kërkesës së patriarkut dhe me këtë rast ai shkroi një pakt me të krishterët, me të cilin u jepte atyre siguri dhe jetë në paqe.

duke marrë me vete pasurinë e tij dhe duke i braktisur faltoret dhe kryqet e tyre, ata do të jenë të sigurt për jetën e tyre dhe di t'i kenë të sigurt faltoret dhe kryqet e tyre, derisa të mbërrijnë në destinacionin e tyre të sigurt. Ndërsa kush qëndron në qytet, ka të njëjtën përgjegjësi siç e kanë gjithë banorët e Il'ja's. Kush dëshiron të shkojë me romakët, le të shkojë me ata dhe do të jetë i sigurt dhe kush dëshiron të kthehet në familjen e tij, le të kthehet dhe do të jetë i sigurt.

Gjithë kjo që gjendet e shkruar në këtë pakt, është besa e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij, dhe besa e kalifëve dhe e besimtarëve, me kusht që ata (të krishterët vendas) ta japin xhizjen e detyruar.

Këtë pakt e dëshmoi Halid ibnul-Velid, Amr ibnul-As, Abdurrahman ibnul-Auf dhe Muavije ibn Ebi Sufjan. U shkruajt dhe u prezantua në vitin pesëmbëdhjetë hixhrij.²

Që nga ajo kohë, Palestina mori pamjen e qytetërimit Islam dhe gjuha arabe u bë gjuha dominuese në vend.

DINASTIA EMEVITE (661 - 750 AD)

Më vonë, pas epokës së ndritur të Kalifëve të drejtë, bota islame hyri nën drejtimin e Dinastisë Emevite, me qendër në Damask të Sirisë. Nga trashëgimitë më të mëdha të lëna nga periudha e Dinastisë Emevite në Palestinë janë Kupola e Shkëmbit, që e ndërtoi Abdul Melik ibn Mervan në vendin nga ku Profeti Muhammed, (a.s), u ngjiti në qiell, në Natën e Israsë dhe të Miaraxhit. Gjithashtu, edhe Mesxhidul-Aksa, me pamjen që ka akoma edhe sot, u ndërtua po në këtë periudhë, nga Velid ibn Abdulmelik. Ndërsa Qyteti Remla në Palestinë, është vendi ku Sulejman ibn Abdulmelik ndërtoi pallatin e tij të famshëm dhe Xhaminë e Bardhë.

DINASTIA ABASITE (750 - 1258 AD)

Pas përfundimit të sundimit të Dinastisë Emevite, Palestina u bë pjesë e Dinastisë Abasite. Palestinën e vizitoi vetë kalifi Me'mun dhe djali i tij, Mehdi. Në këtë periudhë, Palestina vazhonte të ishte pjesë e vendeve islame dhe vendi u integrua edhe më shumë në kulturën islame. Gjatë kësaj periudhe u formuan komunitete të reja, rezultat i

2. <https://lite.islamstory.com/ar/artical/10761>

martesave mes muslimanëve të ardhur dhe popullsisë vendase. Në shekullin e tretë hixhri, në Palestinë erdhën Tulunidët³, ndërsa në shekullin e katërt vendi u sulmua nga Karamitët⁴.

KRYQËZATAT

Nga fundi i shekullit të njëmbëdhjetë, në Palestinë erdhën kryqtarët. Në këtë kohë Evropa po kalonte një periudhë me problem politike, shoqërore dhe ekonomike, mes mungesës së lëndëve të para dhe rritjes së numrit të popullsisë. Gjithashtu po kalonte një periudhë konfliktesh mes mbretërve dhe kalorësve, dhe mes Papës dhe mbretërve të kontinentit. Mësymja ndaj Lindjes do të ishte një zgjidhje qetësuese për të gjitha palët. Procesi i frymëzimit shpirtëror filloi me predikimin e papës Urbani II, në vitin 1095, ku u kërkonte popullit që të shpëtonin varrin e Shenjtë të Krishtit nga duart e muslimanëve dhe pastrimin e Kudsit (Jeruzalemit) prej tyre.

Piteri Vetmitar (Peter the Hermit) udhëhoqi të parën nga fushatat ushtarake, që zgjatën dy shekuj dhe që u njohën me emrin "kryqëzata", ngaqë kishin kryqin si simbol të tyre.

Piteri Vetmitar e pushtoi qytetin Remla, shkatërroi Jafa-n, dhe e rrethonin Kuds me një ushtri numri i së cilës arriti në dyzet mijë vetë. Pas një muaji rrethim, garnizoni i vogël egjiptian që gjendej në Kuds, u dorëzua. Kryqtarët hynë në Kuds në vitin 1099, dhe menjëherë sapo hynë atje, vranë një numër të madh të banorëve arabë vendas, numri i të cilëve sipas shumë referencave historike, arriti në shtatëdhjetë mijë të vranë. Kryqtarët shpallën themelimin e një mbretërie latine në Kuds, duke e zgjeruar ndikimin e tyre në Askalan, Bisan, Nablus dhe Aka, dhe u vendosën në Taberia.

BETEJA E HITTINIT

Prijësi musliman Nurudin Zenki, pas luftimeve të ashpër me garnizonet kryqtare, arriti me sukses të rikthente disa qytete dhe principata të Palestinës.

Këto fitore i vazhdoi me sukses Salahudin Ejubi, i cili arriti që pas fitores së tij në betejën e famshme të Hittinit, në vitin 1187, ta rikthente Bejtul-Makdis (Shtëpinë e Shenjtë në Jeruzalem).

BETEJA E AJN XHALUT

3. Dinasti me origjinë turke (<https://en.wikipedia.org/wiki/Tulunids>).

4. Një rrymë nga sekti Shia Ismailij Shtatësh, që ndërthur në brendësi të tij edhe elemente të zoroastrizmit (<https://en.wikipedia.org/wiki/Qarmatians>)

Në epokën e Dinastisë Memlukes, dy prijësit muslimanë, Sejfudin Kutuz dhe Dhahir Bibers, me betejën e Ajn Xhalut-it (viti 1259), arritën t'i kthejnë mbrapsht hordhitë mongole, të cilat kishin arritur të pushtonin pjesë të mëdha të botës islame. Beteja në Ajn Xhalut, ka qenë një nga betejat më të rëndësishme në historisë islame.

MUHAMMED ALIU

Muhammed Aliu, valiu i Egjiptit, në vitin 1838, vendosi ta zgjerojë mbretërinë e tij, duke i bashkëngjitur asaj edhe vendet e Shamit (Levantit). I biri i tij, Ibrahim Pasha, arriti me sukses që të merrte Arish-in, Gazën, Jaffan, pastaj edhe Nablus-in e Kuds



PASTRIMI PËRFUNDIMTAR

Halil ibn Kalaun, një nga prijësit e Dinastisë Memlukes⁵, vazhdoi të çlironte pjesën tjetër të qyteteve palestineze që kishin mbetur në posedimin e kryqtarëve, derisa vendi u pastrua prej tyre plotësisht në vitin 1291.

Nga trashëgimia e Dinastisë Memlukes që qëndron ende në Palestinë deri në ditët tona, janë disa ndërtesa, disa shkolla, një urë pranë zonës Lud, etj. Gjithashtu ata patën restauruar edhe Kupolën e Shkëmbit dhe Xhaminë e Ibrahimit (a.s).

EPOKA OSMANE

Osmanët i mundën Memlukët në betejën e Merxh Dabik, afër Halebit, në vitin 1516, pastaj hynë në Palestinë, të cilën e sunduan më pas për katër shekuj me radhë.

MËSYMJA E NAPOLEONIT (1799)

Pas pushtimit të Egjiptit nën udhëheqjen e Napoleonit, Franca u përpoq të pushtonte edhe Palestinën, por ushtria u kthye e mundur pas mbërritjes në Aka, pasi dështoi ta thyente qytetin në sajë të fortifikimeve dhe në sajë të trimërisë së udhëheqësit musliman atje, Ahmed Pasha.

5. [https://en.wikipedia.org/wiki/Mamluk_Sultanate_\(Cairo\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Mamluk_Sultanate_(Cairo)).

(Jeruzalemin). Në Nablus dhe Halil, popullata vendase bënë kryengritje masive në shenjë proteste kundër ashpërsisë së Ibrahim Pashës në marrëdhënie me ta dhe kundër taksave të rënda të vëna prej tij. Sundimi i Muhamed Aliut në vendet e Sham-it nuk zgjati më shumë se dhjetë vjet, dhe vendi u kthye përsëri nën sundimin Osman.

PUSHTIMI BRITANIK

Pas fitores së forcave britanike në Turqi, në Luftën e Parë Botërore, nën udhëheqjen e gjeneralit Alenbi (Allenby), në vitin 1917, Palestina hyri nën Mandatin Britanik, deri në vitin 1948.

PUSHTIMI ZIONIST

Më pas, Britania u tërhoq nga Palestina duke u hapur rrugë sionistëve për të krijuar shtetin e tyre në Palestinë, i cili u quaj "Izrael".

Me ndihmën e Britanisë dhe të Shteteve të Bashkuara, grupet sioniste arritën të mposhtin forcat arabe në luftën e vitit 1948. Më pas ata shpallën formimin e shtetit të Izraelit, mbi tokat e pushtuara palestineze.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe



Shejkh Muhamed El-Gazali

Po e them, shkurt e haptas: Gishti i akuzës drejtohet ndaj dy grupe njerëzish: udhëheqësve dhe dijetarëve, të cilët i sollën ymetit tonë këtë prapambetje të kobshme gjatë shekujve me radhë dhe ishin shkak i sëmundjeve, të cilat e paralizuan në kohën kur banorët e tjerë të tokës filluan të heqin pengesat në rrugën e tyre të përparimit. Nuk u mjaftoi të arrijnë retë, por pushtuan universin. Nuk u mjaftoi të ndërtojnë anijet në det si male, por u zhyten në thellësitë e deteve, duke mbajtur me vete koka nukleare shkatërruese në masë.

Për mendimin tim, totalitarizmi politik është një prej shkaqeve të para të paralizimit të mendimit tek myslimanët. Nuk është e lehtë për njeriun të eci me frikë në rrugë duke parë para e prapa se mos i ndodh gjë, ndoshta mund t'i vijë ndonjë dajak në majë të kokës, i cili i merr jetën, ose ndonjë shuplakë në fytyrë që i merr nderin, ose të merret për leckash e të hidhet në burg, ku s'di asgjë për familjen dhe fëmijët e tij!! Nevoja për siguri është si nevoja për ushqim.

Ishte Ibrahim (a.s.), i dashuri i Zotit (xh.sh), i cili vlerësoi të drejtat morale e materiale të njeriut së bashku, kur u lut para se të ndërtonte Qabën, "O Zot, bëje këtë vend të qetë, të sigurt dhe furnizoi banorët e tij prej frutave të ndryshme"¹.

Ndërsa ushtari i urdhëruar qëllon mbi njerëzit duke mos i bërë përshtypje aspak që vë nën këpucët e tij trurin më të madh në botë, sepse ai nuk dallon trurin prej trurit. Ai është i urdhëruar që të qëllojë, ai është vegël njerëzore në duar të diktatorit.

Kur Kur'ani i shenjtë tregon politikën e faraonëve, ai bashkon eprorin dhe vartësin në të njëjtin kallëp: "Me të vërtetë Faraoni, Hamani dhe ushtarët e tyre ishin mëkatarë"². Dhe ndoshta cilëson të gjithë vargun ushtarak zullumqarë: "A të erdhi lajmi i ushtrive të Faraonit e të Themudit. Jo, por ata që nuk besuan janë në gënjeshtëri. Ndërsa Allahu ata i ka rrethuar"³.

1. Kur'ani, El-Bekare: 126.
2. Kur'ani, El-Kasas: 8.
3. Kur'ani, El-Buruxh: 17-20.

GISHTI I AKUZËS

Diktatorit nuk i intereson tjetër, përveç se vetja e tij. Ai shikon vetëm interesat e tij dhe nuk afron tjetër, përveç atë që e kënaqë dhe i bindet.

Kujtoj një herë se në një vend hipi në makinë presidenti së bashku me ministrin, ku për çlodhje, presidenti po ngiste makinën, papritmas përplasat me një pemë në anë të rrugës. Zbriti me vrap ministri që t'i thotë zotërisë së tij: "Makinën e ngisje në rregull por pema kishte qëndruar gabim!!"

Në këtë mjedis të zyrtë prej servilizmi vdesin dhuntitë shpirtërore, kur totalitarizmit të verbër i shtohet edhe mungesa e rriskut dhe pasuria kalon mes gishtave të udhëheqësve të vetëm, atëherë i jep e i merr kujt të dojë, duke ekzekutuar të gjitha moralat e të drejtat.

Kur po lexoja tregimin e shpikjes së makinës me avull, imagjinoja djalin e ri anglez, duke vëzhguar avullin që ngrinte kapakun e enës dhe duke menduar me maturi në shfrytëzimin e kësaj energjie në dobi të njerëzimit, ndihej i qetë, shpresonte dhe krijonte, se askush nuk do ta çonte në dhomat e izolimit për ta rrahur me 100 kamxhikë, si dënim për atë që bëri. Ai nuk do të qëndrojë para ndonjë oficeri duke i thënë: Mendo për atë që të bën dobi ty? Siç thuhet shpesh në lindjen islame(!) Ishte nderimi moral e material në vendin e tij, i cili vendosi ta shpërblente me çmim të lartë, për të cilin shpenzoi mbreti i Anglisë!

Nuk mundem të zgjatem më në këtë temë, por ah, sikur të ngrihej një grup universitar për mbledhjen e gjurmëve rreth personave të shquar në mendimin islam përgjatë shekujve. Ndërsa roli i dijetarëve të sotëm, të cilët kanë ndërprerë veprimtarinë shkencore, duket së pari në kërkimet "kelamije gajbije", metafizike, në degët e fikhut imagjinar dhe në materiale pa dobi, të cilat s'kanë mbarim, pastaj e gjithë kjo llogaritësi si dituria, e cila s'ka dituri mbi të.

Me këto u shkëput rruga e mjekësisë së Ibën Sinës, kimia e Xhabirit, optika e Ibnul Hejthemit dhe logaritmi i Havarizmit. Madje, njohuritë e përparimit e të zhvillimit shkencor tek arabët nuk i gjen në enciklopeditë veçse, në bibliotekat perëndimore dhe te shkrimtarët realistë evropianë!

Ndërsa, përpjekjet e baballarëve tanë në shkencat e astronomisë, jetës, mjekësisë dhe në artet luftarake janë aq të shumta sa nuk mund të numërohen, apo të shkruhen!! Sistemi nervor i njeriut lodhet e dobësohet me çfarë kanë shpikur devijuesit dhe ekstremistët prej ibadeteve e riteve, duke mos u mbetur më kohë të trajtojnë dy mendime e pas

kësaj të mendojnë e të shpikin.

Pasi të ngarkohet myslimani, pas gjithë përmendjeve të ditës e natës të thotë: "Ja Latif" 10000 herë, çfarë i mbetet atij kohë për mendim të zbulojë të panjohurën apo të shpiki diçka të re? Sikur të pushonte në gjumë, pastaj të ngrihej të stërvitet ushtarakisht në tokë, det e ajër e gjitha kjo do të ishte më e dobishme për Islamin. Zoti ynë i lartë i fali muxhahidinët nga detyrimi i kijamul-lejlit⁴, që t'u japë mundësi atyre të përgatiten për luftën e ditës, gjithashtu fali edhe tregtarët, që të qëndrojnë të fortë në fushën e ekonomisë, ndërsa Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush lexon dy ajetet e fundit të sures Bekare, atij i mjaftojnë".

Por, tek shumica e dijetarëve myslimanë shkencat e jetës së gjithësisë janë vullnetare, ndërsa ne lodhemi e sakrifikojmë që të bindim rininë se fjala e Njësimit⁶, po kërcënohet në qoftë se nuk shpikim në këto shkenca!.

Më rastisi të shikoj një student mjekësie me një turrë librash fikhu e hadithi dhe me keqardhje i thashë: Më mirë do të ishte për ty, sikur kjo turrë me libra të ishte në njohuritë në të cilat je i specializuar. Përse nuk konkurron me mjekët e Londrës dhe të Parisit në arritjet e tyre duke shtuar më tepër leximin dhe thellimin tënd?

I përmenda se, si një doktor i ri, miku im, po bisedonte me profesorin e tij për qelizën. Menjëherë profesori zgjati dorën afër një rafti dhe mori një vëllim të madh dhe ia dha doktorit të ri. Çfarë të shikosh, i gjithë vëllimi fliste për qelizën dhe çfarë ka vendosur Allahu prej sekreteve të saj. Mijëra e mijëra libra shkencorë ndihmojnë e mbështesin zhvillimin e ri, i sigurojnë atij sundimin mbi çështjet e jetës në çdo drejtim të saj dhe njerëzit i studiojnë me epsh të gjitha këto lëndë, ndërsa në të njëjtën kohë gjejmë studentë universiteti në njërin prej fakulteteve të këtij lloji, i zënë me replika kundër "xhehmive".⁷

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

4. Latif, emër i Allahut që do të thotë: I Butë.

5. Namazi i natës.

6. Shehadeti, "La ilahe il'Allah".

7. Fraksion, rrymë, mendim, i cili e kufizon blasfeminë vetëm me zemër, d.m.th njeriu quhet jobesimtar vetëm atëherë kur mohon me zemër, ndërsa veprat e tij, edhe n.q.s janë të ndaluara për t'u kryer dhe i kryen, nuk kanë rëndësi dhe nuk ndikojnë në besimin e tij, po qe se nuk ka qëllim të keq me zemër (sh.p).



Xhahid Bushati, shkrimtar

1.

Të kam premtuar se do t'i puth duart
edhe pse jam larg
diku nën një qiell të hirsosur
si një zemër e brengosur,
tokën e varrin i mbush me lot.

Të kam premtuar se do t'i puth duart
edhe pse jam larg
ku pragu bëhet shpirt,
ku syri më fal dritë,
e retë qëndrojnë si pritje të pashpresa.

Të kam premtuar se do t'i puth duart
edhe pse jam larg...
Udhëtoi era e mallit
e më solli përkëdhelitet.

I puth e s'ngopem së puthuri,
i puth e nuk vdes së puthuri
Koha është si një ëndërr pa orë,
kujtimet e fjetura i zgjon ajo dorë...

Të kam premtuar se do t'i puth duart
i kishe me plagë e plagët m'i fshihje
e pafaj, moj ëndërrmira
trishtimin e fëmijërisë sime
e ktheje në mijëra trëndafila.

Të kam premtuar...

- Triptik për Nënë -

2.
Të kam premtuar se do t'i puth sytë
edhe pse jam larg...
Kur i kam humbur ato sy
prapë kam biseduar me Ty!

Të kam premtuar se do t'i puth sytë
edhe pse jam larg
diku nën një qiell të huaj, i paemër...
Nuk isha vetëm
dy sy të shtrenjtë i kisha në zemër...

Të kam premtuar se do t'i puth sytë
edhe pse jam larg
aty, ku qyteti i panjohur më vret çdo ditë,
si bekim shpirti
kisha sytë e tu plot dritë.

Të kam premtuar se do t'i puth sytë
që lotët i mbajte për vete,
ato lot që ktheheshin në ëndrra evladi,
për evladin shterroje dete e dete...

I puth ato sy e s'ngopem së puthuri,
i puth ato sy e nuk vdes së puthuri!
Amanet, moj dritë e hënës
dua të vdes
duke puthur sytë e Nënës!

3.

Të kam premtuar se do ta puth pagjumësinë tënde
edhe pse jam larg...,
aty, ku shpesh, bota natën humb...
Ti je tej unë, e pagjumël!

Të kam premtuar se do ta puth pagjumësinë tënde
edhe pse jam larg...
Në pagjumësi gjithçka humb...
Si një kurorë pagjumësie
shndrit e këndon një ninullë...

Të kam premtuar se do ta puth pagjumësinë tënde
edhe pse jam larg...
Të shoh te dritarja e pritjes
dhe e mallit,
me kujtimet e shpirtit puth
sytë e djalit.

Të kam premtuar se do ta puth pagjumësinë tënde
me emrin: heshtje,
me emrin: buzëqeshje.
me emrin: ngadalë,
pagjumësi e kthyer në mall...

Shkodër, shtator 2018

“EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)” - DR. MUHAMMED A. JEMANI

(LIBËR I PËRKTHYER NGA **H. VEHBİ S. GAVOÇI** - SHKODËR, 1996)

DASHURIA E SAHABËVE PËR TË DËRGUARIN E ALLAHUT (A.S)

Ne e kemi detyrë ta duam Profetin (a.s) më shumë se veten tonë. Kjo dashuri sa vjen e forcohet, kur njeriu mendon të mirat që na kanë ardhur prej tij.

Shokët e vet e kanë dashur shumë atë Zotëri. Më poshtë po përshkruajmë shembuj prej disa shokëve të tij.

1. Theubani, ka qenë një shok (sahabe) i vobektë që i shërbente shpeshherë Profetit (a.s). Për disa ditë mungoi dhe nuk erdhi ta takonte Profetin (a.s). Kur u paraqit mbas disa kohësh, erdhi i lodhur e me fytyrë të zbetë si qiri, hyri ashtu pa bërë zë. Ai Zotëri e pa menjëherë dhe e pyeti: “Çka ke, Theuban?”

Ai iu përgjigj: “O i dashuri Profet, ti e di se nuk ka punë që më ndalon, kur dua të të shoh. Por unë mendova se kjo jetë nuk është e përhershme, kemi për të vdekur e do të ndahemi. E në qoftë se Zoti (xh.sh) me mirësinë e vet më fut në xhenet, mendova se si e ku kemi për t’u parë? Kjo gjë më shtiu në mendime dhe më shqetësoi sa që u sëmura.”

Kur dëgjoji këtë përgjigje, Profeti (a.s) buzëqeshi duke i thënë se Zoti (xh.sh) ka treguar se njeriu do të jetë me atë që ka dashur në këtë jetë dhe këndoi ajetin: “Ata që i binden Zotit dhe Profetit do të jenë me ata që Zoti iu ka dhënë të mirat prej Profetëve, dëshmorëve e njerëzve të mirë. Sa e bukur është ajo shoqëri!”

2. Ebu Bekri. Kur i erdhi leja Profetit (a.s) për të emigruar në atë ditë të nxehtë, në drekë takoi Ebu Bekrin, shokun e vet të ngushtë dhe i kallëzoi se i kishte ardhur leja për emigrim. Ebu Bekri iu lut Profetit ta pranonte si shok në atë rrugë të rrezikshme. Kur Profeti e pranoi, ai qau nga gëzimi. Vajza e tij, Aishja, kallëzon e thotë: “Nuk kam parë kurrë më parë se si qau burri nga gëzimi!”

Secili doli nga shtëpia e vet dhe u takuan në një vend të caktuar. Prej aty morën rrugën për në Medine Munevere. Gjatë rrugës Ebu Bekri disa herë i dilte përpara Profetit (a.s) e disa herë vonohej, duke ardhur pas tij. Kur e pyeti Profeti (a.s) se pse vepronte ashtu, Ebu Bekri iu përgjigj: Trembem se mos na del armiku përpara dhe dua të të mbroj me veten time dhe herë kujtoj se ndoshta vjen prapa dhe përsëri dua të të ruaj me veten time.”

Kështu vazhduan rrugën, derisa erdhën në malin Theur. Aty hynë në një shpellë. Para se të hynin, Ebu Bekri kërkoi nga Profeti (a.s) të duronte e të rrinte pak përjashta, sa të shihte se mos kishte ndonjë bishë ose keqbërës në shpellë që mund ta dëmtonte Profetin (a.s). Kur i mbylli të gjitha vrimat në tokë, hyri Profeti. Mbas pak ai ra në gjumë në prehrin e Ebu Bekrit. Ky kishte vënë këmbën mbi një vrimë që kishte mbetur pa u mbyllur. Me të vërtetë, në atë vrimë ishte një gjarpër, që e ndjeu erën e njeriut. Ai e thumboi disa herë Ebu Bekrin, i cili ndjeu dhimbje të madhe. Por çfarë të bënte? Nuk mund të hiqte këmbën që gjarpri të dilte jashtë e ta mbyste, sepse Profeti po flinte i qetë në këmbën e në prehrin e tij. Ai duroi, derisa i dolën lotët nga dhimbja, të cilët i ranë mbi fytyrën e Profetit (a.s). Ai u zgjua dhe pyeti se çfarë kishte. Ky i kallëzoi. Atëherë e hoqi këmbën nga vrima dhe doli gjarpri, të cilin e mbytën menjëherë.

Mbas pak erdhën disa idhujtarë duke i kërkuar nëpër mal. Bile njëri prej tyre hipi mbi shpellën ku ishte fshehur Profeti (a.s). Ebu Bekri e pa dhe tha: “O Profet i Zotit, unë po frikësohem se mos po të dëmtojnë ty, e po të të dëmtojnë ty, humbet Islami, nuk pyes për veten time, sepse unë jam njeri i thjeshtë.”

Profeti (a.s) ia zbuloi zemrën, e qetësoi dhe ia largoi frikën duke i thënë, siç është shkruar në Kur’an: “Mos u tremb, Zoti është me ne, na ruan Ai.” Kështu që idhujtarët u larguan mbasi panë se aty merimanga kishte endur rrjetën e vet dhe se një pëllumb kishte ndërtuar çerdhen. Mbas tri ditësh dolën nga shpella, prej ku morën rrugën për në Medine. Ecnin natën dhe pushonin ditën.¹

3. Zejdi, djali i Dethinës. Zejdi qe një prej 40 njerëzve të ditur, që Profeti (a.s) i dërgoi të mësonin disa fise arabe, në bazë të kërkesës së tyre. Gjatë rrugës u tradhtuan dhe u rrethuan nga qindra kalorës të cilët kërkuar të dorëzoheshin. Kështu të rrethuar, duke patur pak armë, luftuan derisa u vranë 38 prej tyre. Mbetën vetëm dy. Këtyre iu dha besa se nuk do të dëmtoheshin dhe u dorëzuan. Njëri pa se me pabesi po ia lidhnin duart. Zbriti shpejt nga kali, por e vranë menjëherë pabesisht. I dyti, Zejdi, nuk

1. Megjithëse myslimani beson se Zoti bën çfarë do.

mundi të ikte, prandaj edhe e lidhën.

E dërguan të lidhur në Mekë dhe vendosën ta vrisnin për hakmarrje të një idhujtari që ishte vranë në Luftën e Bedrit. E nxorën Zejdin jashtë qytetit, sepse sipas zakonit në Mekë nuk vritej kush. U mblodhën disa idhujtarë të shihnin atë poshtërsi duke u vranë një njeri që ishte i pafajshëm. Ndërsa ishte lidhur, qëllloi aty Ebu Sufjani. Para se t’ia ekzekutonin, Zejdi kërkoi leje të falte dy rekat namaz. Ia plotësuan dëshirën. Kur u kthye tha: “Pata dëshirën të vonoj faljen, por mendova se mos ndoshta ju po kujtoni se unë e kam frikë vdekjen.”

Në këtë çast Ebu Sufjani e pyeti Zejdin: “A do të të pëlqente që të ishe në shtëpinë tënde, me familjen tënde e të ishte Muhammedi këtu në vend tënd?”

Ai iu përgjigj: “Betohej që jo! Mua më vjen keq po ta shponte atë Zotëri një ferrë e vogël, e unë të isha në shtëpinë time rehat”. Kur dëgjoji këto fjalë, Ebu Sufjani tha: “Nuk kam parë njeri që do kënd, sa e duan shokët Muhammedin.”

Pastaj ata e plotësuan atë krim të shëmtuar dhe e vranë atë djalë trim, shok i Profetit (a.s).

4. Ebu Talha. Në Luftën e Uhudit u zhvillua një ndeshje e pabarabartë në mes 3000 idhujtarëve dhe 700 myslimanëve. Kur në një moment myslimanëve u buzëqeshi fitorja, disa luftëtarë i lanë vendet e tyre strategjike duke kujtuar se mbaroi lufta dhe nuk zbatuan urdhrat e Profetit (a.s), që i kishte porositur të mos i lëshonin pozicionet, sido që të ngjiste.

Ushtria armike përfitoi nga ky gabim dhe gjeti rastin të sulmonte nga mbrapa. Si rrjedhim ushtria e vogël myslimane u shpartallua. Në këtë rast idhujtarët përhapën lajmin se u vra Profeti (a.s).

Në atë kohë Profeti (a.s) mbeti i veçuar me disa shokë pa luajtur nga vendi. Disa idhujtarë u afruan, gjoja për ta vranë. Në mbrojtje të Profetit (a.s) ishte edhe Ebu Talha, i cili hidhte shigjetat kundër sulmuesve dhe pastaj e mbronte Profetin nga shigjetat e armiqve. Kur ai gjuante, Profeti (a.s) ngrinte kokën për të parë se nga po vjen shigjeta. Në këtë rast Ebu Talha ngrinte gjoksin e vet për të mbrojtur Profetin (a.s). Ai thoshte: “U bëfsha fli unë me babë e me nënë, e ty mos të rëntë asnjë shigjetë, le të jetë gjoksi im mburojë e gjoksit tënd.” Dhe kështu vazhdoi, derisa u larguan armiq të

nga vendi i luftës.

5. Një grua prej një familjeje besimtare. Kur u kthye Profeti (a.s) nga Lufta e Uhudit, ku u plagos, dolën shumë njerëz në rrugë për ta parë. Mes tyre ishte edhe një grua. Asaj i kishin thënë se i ishin vranë babai, burri dhe vëllai, por ajo kishte pyetur: Po Profeti (a.s) si është? - Mirë, - iu përgjigjën. Kur Profeti erdhi, pa njerëzit që e prisnin. I treguan gruas se cili ishte Profeti. Porsa e pa shëndosh e mirë, ajo tha: “Çdo vështirësi jashtë teje është e vogël.”

6. Maliku, djali i Enesit. Është prijësi i Medhhebit të dytë që quhet Maliki. Ky jetonte në Medine. Një ditë, kur ishte në xhami të Profetit (a.s) me kalifin Ebu Xhafer El-Mensur, ky i fundit e ngriti pak zërin në bisedë e sipër.

Atëherë Maliku me solemnitetin e një dijetari e me sjelljen që duhet, i tha: “Nuk bën të ngrihet zëri në xhaminë e Profetit (a.s), as afër saj, sepse Zoti (xh.sh) i ka qortuar ata që flasin me zë të lartë dhe i ka lavdëruar ata që nuk e çojnë zërin gjatë bisedës.”

Pas kësaj këshille të urtë Kalifi e pyeti: “Unë po vizitoj varrin e Profetit (a.s) (që është në xhaminë e tij) dhe kur dua të lutem, nga duhet të sillem, nga varri apo nga Kiblja (Qabeja)?”

Maliku, me dinjitet iu përgjigj: “Pse po ia sjell shpinën Profetit (a.s), i cili do të jetë ndërmjetës para Zotit (xh.sh), siç ka qenë edhe për Hz. Ademin?”

Tregojnë se ky hoxhë i madh në Medine, në shenjë respekti për Profetin (a.s), nuk hipte në kalë apo në ndonjë kafshë tjetër, por ecte në këmbë. E këtë e shpjegonte duke thënë: “Frikësohem se kali e vë këmbën mbi atë vend ku Profeti (a.s) dhe sahabet gjatë faljes kanë vënë kokat.”

Ebu Halebin, një shok të Profetit (a.s) e pyetën: “Si ka jetuar Profeti (a.s) në shtëpi të vet? “Ai iu përgjigj: “Kur hynte ai Zotëri në shtëpi, e ndante kohën në tri pjesë: një për Zotin (xh.sh), duke u falur dhe përkujtuar Atë; një për familjen e vet, për të ndenjur e biseduar me njerëzit e familjes; të tretën për vete, për pushim. Edhe këtë pjesë e ndante ndërmjet vetes e shokëve që kishin nevojë për Të.”

E pyetën përsëri Ebu Halebin për Profetin (a.s) se si ishte ai në marrëdhënie me shokët. Ai bëri këtë karakteristikë të saktë për Profetin (a.s): “Ka mbrojtur gojën e vet nga çfarë nuk i interesonte, i afronte dhe i donte shokët e nuk i largonte; çdo besnik që i vinte për vizitë, e nderonte dhe e vinte në krye të fisit të vet; përpiquej që njerëzit të ishin të kënaqur prej tij, prandaj gjithnjë

ishte buzagaz dhe i respektuar; pyeste për shokët që nuk i shihte, pyeste për gjendjen e njerëzve; nuk pranonte t’i fliste kush keq për të tjerët; të mirën e njihte për të mirë dhe e donte, të ligën për të ligë dhe e urrente; njerëzit më të mirë tek ai ishin me të vërtetë më të mirë; më i miri tek ai ishte ai që e donte të mirën për të gjithë.”

Buhariu, duke interpretuar fjalët e Enesit (r.a), tregon se ai ka thënë: Isha një ditë në rrugë me Profetin (a.s). Na doli para një arab dhe e kapi Profetin për fyti, sa iu skuq fytyra duke i thënë: “M’i ngarko devetë me ushqime, por këto i dua nga pasuria e Zotit dhe jo nga pasuria jote! Ai Zotëri kërkoi t’ia lëshonte fytyrën e, kur u lirua, i tha se ushqimet po ia jepte nga pasuria e Zotit. Kështu ia ngarkoi dy deve, njërën me grurë e tjetrën me hurma. Pastaj i tha arabit: “Unë ta krewa porosinë, por duhet të kem të drejtën të të kap për gryke, siç më kape ti mua.” Arabi iu përgjigj: “Jo!”

Pse, i tha Profeti, - kush më ndalon? Arabi iu përgjigj: “Jo, nuk të ndalon kush, se Ti nuk e shpërblen të keqen me të keqe.”

Ai Zotëri nuk foli më, por e la arabin të shkonte në punë të vet.”²

Në Luftën e Hunejnit, që u zhvillua një muaj mbas hapjes së Qabes së madhërueshme, një arab ia shkeli këmbën Profetit me këpucën e rëndë që kishte veshur, sa i dhëmbi fort. Ai Zotëri nga dhimbja i ra me një thupër që kishte në dorë. Të nesërmen Profeti (a.s) çoi dhe e thirri arabin. Ai i mjeri, kur dëgjoji emrin e vet, priti ndëshkimin që meritonte. Kur doli para tij, ai Zotëri i tha: “Ti dje me vrave këmbën pa dashje dhe unë të rashë me një thupër. Merri këto 80 dele e shko.”

Ka shumë arsye që i nxitin myslimanët ta duan atë Zotëri më shumë se çdo gjë në këtë jetë dhe të dëshirojnë të ndjekin rrugën e tij, për të qenë pranë tij në xhenet Firdeus.

Dashuria ndaj Profetit (a.s) i nxit njerëzit të zbatojnë urdhrat e tij, të largohen nga ç’është e ndaluar të bëhet, të besojnë, të luten dhe të preferojnë të plotësojnë kërkesat e të tjerëve para atyre vetjake.

Ai Zotëri nuk pëlqente të dallohej prej të tjerëve. Kur hynte në një dhomë, nuk i pëlqente që ndokush t’ia lëshonte vendin në qoshe, por ulej ku të gjente vend bosh. Mirëpo me doemos ku rrinte ai Zotëri, bëhej qendra e kuendit. Nuk i pëlqente kurrë që dikush t’i rrinte në këmbë si roje, siç e shohim sot tek të

2. Buhariu

parët e vendit.

Njëherë ai Zotëri doli në shtëtitje me disa shokë. Ata kishin me vete një dele, të cilën vendosën ta prisnin e ta hanin. Njëri tha: “unë e pres”, tjetri tha: “unë e copëtoj”, një tjetër tha: “unë po sjell ujë”. Edhe Profeti (a.s) tha: “Unë po mbledh drutë për ta pjekur. “Të gjithë i thanë: “Jo, o i Dërguari i Zotit, e kryejmë ne atë punë.” Por ai u tha: “E di se e bëni mirë dhe këtë punë, por unë nuk dua të dallohem prej jush, sepse Zoti nuk e pëlqen atë njeri që dallohet nga shokët e vet.”

E si mos ta duam atë njeri aq të mençur, të sjellshëm e që interesohet për të tjerët?

Njëherë erdhi një arab për të kërkuar ndihmë tek ai Zotëri. I dha aq sa kishte, pastaj e pyeti nëse i kishte dhënë aq sa kishte nevojë. Arabi u përgjigj: “Jo.” Shokët u pezmatuan nga kjo përgjigje, ndërsa Profeti (a.s) e mori me të butë arabin në shtëpi duke i dhënë më shumë, pastaj e pyeti: “A të dhamë sa duhet?” Arabi iu përgjigj: “Po, të falem nderit!”

Profeti iu lut arabit që të nesërmen të vinte e t’i takonte shokët, sepse ata ishin zemëruar nga sjellja e tij. Dhe kështu u bë. Arabi erdhi dhe e falënderoi Profetin para të gjithëve për ndihmën bujare.

Profeti u drejtua nga shokët duke thënë: “Shembulli im me ju është si puna e atij njeriut që kishte një deve. Një ditë i iku deveja. U çuan shokët ta ndihmonin për ta zënë, duke e gjuajtur me gurë. I zoti i devesë u tha që t’ia linin atij, këtë punë. Mori pak bar dhe e thirri devenë e vet, derisa ajo u kthye dhe i vuri litarin. Pastaj iu drejtua shokëve: “Sikur edhe unë të zemërohesha me këtë njeri, siç vepruat ju dje, do të ikte, do të linte fenë dhe do të shkatërrohej, kështu që e shpëtova atë nga mosbesimi.”

Zoti (xh.sh) ka thënë për këtë Zotëri: “Harisun alejkum” që d.m.th. “I interesuar për të mirën tuaj.”

Njëherë tjetër një njeri hyri në falje dhe e pyeti komshiun: “Në të satin rekat jemi?” Ai i ra me bërryl duke i dhënë të kuptonte se gjatë faljes nuk duhet të flitet. Mbas faljes komshiu e mori atë njeri dhe e çoi tek Profeti (a.s) duke i treguar se çfarë kishte ndodhur. Më vonë ky ka thënë: “Betohej se nuk kam parë mësues më të mirë se Profeti (a.s), sepse ai as më shau, as më qortoi, por më tregoi me fjalë të ëmbla kushtet e faljes e disa rregulla themelore të saj.

Tregime të tilla janë të shumta. Ne këtu nuk dëshirojmë të zgjatemi, por kemi si qëllim të përmendim vetëm disa pikla të ndritshme, sa për të plotësuar disi nevojën e shpresojmë se këto mjaftojnë.

Smajl Bala, *studius*

KONTRIBUTI I HOXHALLARËVE NË ARSIM

praktike. Në klasat më të larta të mejtepit mësoheshin edhe të tjera veprime matematikore më të avancuara, si dhe kaligrafi, turqisht, etj.

Mejtepet krijuan rritjen e nivelit arsimor fetar dhe një vijueshmëri të suksesshme, pasi djemtë që kryenin mejtepin kishin të drejtë të vazhdonin shkollat më të larta, në shkollat Ruzhdije, Medrese, etj.

Cikli më i lartë i shkollimit ka qenë shkolla Ruzhdije, ekuivalente me shkollat 7 vjeçare. Në Shkodër kjo shkollë u çel në vitin 1857, në Pazar të Vjetër me iniciativën e valiut (guvernatorit të Shkodrës). Ishte moderne dhe me programe të avancuara për kohën dhe në vitin 1865 u transferua në qytet, në periferi të Fush Çelës.

Shkolla fillimisht kishte dy mësues. Bazuar në diplomat që merrnin, jepeshin lëndët mësimore; Besim, arabisht, arithmetikë, gjeometri, gjeografi, histori, diktat, kontabilitet, vizatim, etj.

Medresetë ishin shkolla të një rangu me ato të mesmet dhe kishin në program lëndët; P.sh: Në medresenë e viteve 1944 - 1947 ishin lëndët mësimore: Nga shkencat shoqërore, këndim, gramatikë, hartim, drejtshkrim, bukurshkrim, histori, gjeografi, logjikë. Nga shkencat e natyrës, arithmetikë, gjeometri, botanikë, kimi, fizikë. Nga lëndët fetare, Kur'an, Besim, moral islam, si dhe gjuhë të huaja, arabisht, frëngjisht. Gjithashtu mësohej, gjimnastikë, vizatim, punë dore, muzikë, higjienë, si dhe nota për sjellje dhe zell. Prej këtyre lëndëve, 15 jepeshin me provim para një komisioni provues, si besimi, Kur'an, gjuhët e huaja (arabisht dhe frëngjisht), këndimi, gramatika, hartimi, drejtshkrimi, historia, gjeografia, nahiv arabi, muqemati, raviza, matja dhe dituri natyre.

Myderrizët dhe hoxhallarët mësues kanë qenë të nderuar dhe të përgatitur. Kanë një meritë në këtë rrafsh, jo vetëm për nivelin e lartë arsimor, teorik e praktik të dijeve që zotëronin, por edhe falë aplikimit të metodave pedagogjike të përparuara mësimore të kohës, ç'ka lartësonte edhe me shumë punën e tyre dhe të përgatitjes së nxënësve.

Përgatitja e nxënësve i shërbente edhe çështjes kombëtare. Por, për mësuesit ishte edhe çështje ekuivalente, me atë të fesë, pra motoja ishte "Fe – Atde".

Në Shkodër, në vitin 1902 qe hapur shkolla Ruzhdije Asqeri (shkollë ushtarake). Shkolla në Parrucë u ndërtua me iniciativën e komandantit të Shkodrës, Shaqir Pasha. Ndërtesa ka qenë dy katëshe me dhoma e salla studimi të mëdha. Ajo kishte drejtor ushtarak, ndër ta kanë qenë: Sadetin Beu, pas tij, Tushdi Beu, Adem Rizai, etj. Kishte një staf pedagogjik prej 12, 13 mësuesish ushtarak dhe hoxhallarë mësues, të gjithë me akademi ushtarake. Krahas atyre ushtarake mësohej edhe një program fetar e laik. Këtu dhanë mësim edhe hoxhallarët e nderuar, si: Hafiz Ibrahim Kaduku, Hysejn ef. Vuthi, Hafiz Abaz Golemi e mësuesi Sheuqet Muka. Lëndët që zhvilloheshin ishin: turqisht, letërsi turke, arabisht, persisht, frëngjisht, matematikë, gjeometri, algjebër, trigonometri, hartografi, histori, gjeografi, kontabilitet, vizatim, gjimnastike.

Nga dyert e këtyre shkollave dolën emra të tillë që më vonë u bënë të njohur, ulema të aftë të dijeve islame, në studime të thella shkencore, shoqërore dhe politike, drejtues institucionesh, etj: si Jusuf ef. Tabaku, Hafiz Abaz Golemi, Hysen ef. Vuthi, Molla Ahmet Kalaja, Hasan ef. Potgorica, Daut Boriçi, Molla Veli Anamali e shumë të tjerë.

Është për të përmendur edhe një fakt tjetër që ndikonte në edukimin, veçanërisht fetar, ka qenë dersi (mësimi fetar). Nga hulumtimet që unë kam bërë për arsimin dhe kualifikimin e hoxhallarëve, me rezulton se vend të rëndësishëm ka zënë dersi, që është vazhdim i mësimave fetare, sipas një programi të mesëm apo të lartë të shkollimit, për të gjithë ato që kishin kryer mejtepin, ose medresenë. Dersi është dhënë nga myderrizët të aftë dhe të përgatitur, të kualifikuar me teologji e jurisprudencë islame.

Kane ekzistuar dy forma mësimi. Së pari: Kur myderrizët i kanë marrë nxënësit (telebe) në rrethin e tyre, kur ato kishin kryer mejtepin dhe u kanë mësuar atyre mësimet të vazhdueshme, vetëm fetare, derisa kane kryer programin teorik islam, apo të jurisprudencës me programe të nivelit të mësimi arsimor. Në përfundim të së cilës i është dhënë diploma (ixhazeti) përkatës. Së dyti: Kur nxënësi, apo studenti ka kryer studimet e mesme në medrese dhe i është futur studimeve më të kualifikuara (të larta)

të teologjisë dhe të jurisprudencës në katedrat e myderrizëve, të profesorëve dhe kanë marrë diplomën (ixhazetin) përkatës. Në këto dy forma në përfundim nxënësit, apo studentët kanë dalë para një komisioni provues të ngritur për këtë qëllim, i cili vlerësonte aftësinë e secilit nxënës e student dhe nëse ishin të aftë dhe kishin përvetësuar programin merite ixhazetin, në të kundërtën ata që nuk kishin fituar aftësitë e duhura, ishin të detyruar të mësonin përsëri dhe të merrnin ixhazetin. Me këtë shkollim nxënësi apo studenti ishte i aftë për të kryer detyrën fetare, atë të imamit në xhami, apo në vende të tjera fetare.

Rëndësi të veçantë në arsimimin e nxënësve apo të studentëve kanë luajtur një rolë të rëndësishëm bibliotekat fetare e laike, ku kishin mundësi të merrnin libra, të cilëve u rekomandonin myderrizët e lëndëve, si ato fetare e laike.

Për programet pedagogjike në këto shkolla, fillimisht fetare dhe më vonë edhe të lëndëve të kulturës së përgjithshme, të cilat u futën mbas nxjerrjes së fermanit të sulltanit në vitin 1848, i cili lejoi futjen në universitete, medrese e ruzhdije lëndët e kulturës së përgjithshme dhe u arrit që krahas edukimit shpirtëror e fetar hoxhallarët morën kulturë të përgjithshme, të cilët me arsimimin e tyre u emëruan mësues në këto shkolla fetare dhe të kulturës së përgjithshme, duke dhënë një kontribut të çmuar në edukimin e brezit të ri të arsimuar.

Janë shumë hoxhallarë që dhanë mësim në këto shkolla fetare e më vonë në ato laike, private, shtetërore, pas vitit 1913. Shembull janë hoxhë Muhamed Duka, i cili dha lëndën e historisë, Molla Isuf Kraja, i cili dha lëndën e historisë dhe të gjeografisë në shkollën Ruzhdije. Këta hoxhallarë mësues qenë edhe veprimtarë të shquar të Rilindjes tonë kombëtare. Ja si shkruan Prof. Dr. Hajrulla Kuliqi, në monografinë, "Kraja në Mote": "Një shkollë tjetër me prejardhje nga Kraja ishte edhe Molla Isuf Kraja. Ai ishte një nga veprimtarët më të shquar të Rilindjes tonë kombëtare në Shkodër dhe i arsimi kombëtar. Molla Isuf Kraja, krahas Luigj Grakuqit, Musa

Boriçi, Anton Xhanonit, Ali Ulqinakut, Ndre Mjedes, etj. Ishte një nga burrat atdhetar më të shquar të Shkodrës e më gjerë".

Me riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, në qershor të vitit 1916 me qendër në Shkodër, u krijua mundësia e hapjes së shkollave laike shtetërore në të gjithë Shqipërinë (ndonëse në Shkodër shkollat laike janë çelë që në vitin 1913, me iniciativën e Hafiz Xhemal Naipit, kadi dhe me vonë myfti i Shkodrës.

Për hapjen e shkollave laike, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit bashkëpunoi me Myftinitë për fillimin e mësimave laike nëpër institucionet fetare, në mejtepe, e në medrese të ngritura pranë xhamive apo godina në vete. Përkrah mësuesve laikë, në këto shkolla shumë hoxhallarë mësues u bënë drejtues (drejtorë),



siç ishte Hafiz Ibrahim Repishti, i cili zgjidhet kryetar i komisionit të arsimit për qarkun e Shkodrës, Hafiz Abaz Golemi, drejtor i shkollës së Parrucës, deri në vitin 1925, që ndërroi jetë, Hysejn ef. Vuthi, inspektor i arsimit në Shkodër dhe drejtor i shkollës Rus-Haslikaj etj, të cilët u vuan në krye të detyrave dhe punuan me shumë përkushtim për zhvillimin e arsimit laik dhe në edukimin e fëmijëve tanë.

Në ngjarjet e mëdha historike, hoxhallarët mësues qenë edhe luftëtarë, nxitës të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare, si në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në Kongresin e Manastirit, e deri në ngritjen e flamurit kombëtar në Vlorë, etj.

Objektet fetare arsimore që u vunë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit me miratim të Myftinisë së

Shkodrës: Mejtepi i Molla Medos, në lagjen Zdralej (Rus i Madh), i cili më parë kishte emrin mejtepi i Hafiz Kasemit dhe pastaj këtu dha mësimet fetare Molla Medoja me të vëllanë, Salon. Falë kontributit të tij dhe të vëllait, mejtepi u shqua për përvetësim të thellë të mësimave, për edukatë dhe sjellje të mirë, ku u arrit të mësonin deri në 500 nxënës. Mejtepi në vitin 1916 u kthye në shkollë laike, i pari institucion fetar musliman. Këtu Molla Medoja emërohet drejtor dhe më vonë mësues besimi.

Në vitin 1919 me vendim të I.A.SH. fillon mësimi fetar (mejtep) me mësues besimi Hafiz Ibrahim Dibra. Pra, është pasues i mejtepit Molla Medos dhe një ndër 19 mejtepet të hapura në gjuhën shqipe me vendim të M.A.Tiranë. Duke qenë ky hafiz (hoxhë) i aftë dhe i përgatitur, e përkrahën shumë shpejtë hapjen e shkollës dhe pas një pjesëmarrjeje të lakmueshme, shembulli i mësimdhënies së tij dhe i asimilimit të programeve nga nxënësit, u përgjithësua si ndër me të mirët e kohës, ndaj dhe vetëquhej me emrin e Hafiz Ibrahim Dibra. Më vonë këtu fillon mësimet medreseja e vitit 1925, ku më parë ishte në rrugën Dervishbeg në Parrucë. Në vitin 1944 - 1947, u çel përsëri medrese, e cila mori emrin e këtyre viteve (1944-1947).

Mejtepi i Hafiz Harapit, i

cili i filloi mësimet në shtëpinë e Jakup Dervisheviqit, e më pas pronë e familjes Perdej, përballë furrës së Bejlikut, në rrugën "Naim Gjylbegu". Këtu dha mësim një hoxhë zeshkan, prandaj mejtepi mori emrin "Hafiz Harapit". Falë shembullit të tij dhe jashtë sferës fetare, ai nxënësve, veç lëndëve fetare, u mësonte fëmijëve edhe njohuri nga shkencat, si matematikë, histori, gjeografi, etj. Puna e Hafiz Harapit vlerësohej shumë nga nxënësit dhe komuniteti i prindërve për lidhjet organike që bënte në mes të teologjisë islame e jetës së përditshme. Mësimet i zhvillonte në gjuhën turke, kështu që fëmijët e përvetësuan gjuhën turke e arabishte, njëkohësisht mësuan edhe njohuri të lëndëve të përgjithshme. Në sajë të shkollimit të Hafizit dhe të metodave të avancuara e të njohurive shkencore të nxënësve, shtypi i kohës,

Shkrimet autoriale nuk përfaqësojnë detyrimisht mendimet dhe pikëpamjet e gazetës!

në vitin 1913, shkruante: “Merret vesh se në Shkodër do të çelen 19 mejtepe, të gjitha në gjuhen shqipe”.

Këto mejtepe u hapën me iniciativën e qeverisë së Ismail Qemalit. Mbi këtë bazë Ministria e Arsimit hartoi programet përkatëse, mbasi ishin të bindur se hoxhallarët mësues e zotëronin gjuhën shqipe dhe e realizonin atë më së miri. Prandaj nga përgatitja e tyre Ministria e Arsimit, i emëroi mësues në këto shkolla, si dhe në shkollat laike shtetërore. Pas një inspektimi nga I.A.SH. në këtë mejtep konstatoi se Hafizi kërkonte rregull, disiplinë dhe përparim në mësim, I.A.Sh. udhëzonte mejtepet e tjerë që të ndiqnin shembullin dhe metodat e Hafiz Harapit, mbasi petku fetar që i kishte hije, la gjurmë të pashlyeshme në memorien e bashkëkohësve të tij dhe ka arritë deri në ditët tona, që ne po i lexojmë dhe po i marrim për referenca. (Gazeta “Shqipëria e Re” viti i nr.24.dt.25/09/1913)

Mejtepi i lagjes Parrucë.

Ka qenë ndërtesë në vete. Aty dhanë mësim shumë emra të njohur, por më shumë spikati në vitin 1917, kur aty dha mësim Molla Fasli Zylja, i cili me aftësitë e me teologji të lartë islame, të përkushtimit e të metodave të përparuara që aplikoi bëri që të ketë përvetësim cilësor të lëndëve teorike fetare, por edhe atyre të përgjithshme. E veçantë është së këtu u emërua edhe një mësues laik. Si i tillë, ai u bë një ndër mejtepet më me zë, e të frekuentuara në Shkodër.

Mejtepi i xhamisë të lagjes Bahçallëk, u kthye në shkollë laike në vitin 1921, për tre vjet reshtë dhe më vonë kaloi përsëri në mejtep. Mbas çlirimit kaloi përsëri në shkollë. Këtu edhe unë mora mësim. Ndërtesa ka qenë 6x4x3 me 4-5 këmbë shkallë. Më vonë shërbeu për çerdhe dhe kopsht.

Mejtepi i xhamisë së lagjes Ajasëm, i cili në vitin 1923, u kthye në shkollë femërore laike. Për ta pohuar një fakt të tillë, po japim korrespondencën e inspektorit të arsimit Shkodër, të asaj kohe, Ismail Anamali me M.A. Tiranë, Ai shkruan: “Zyra e vakfit këtu donë me folë për ndërtesën e shkollës femërore në Ajasëm, që gjendet afër xhamisë dhe sot përdoret prej kësaj zyre, i cili ka qenë i ndërtuar nga populli i lagjes”. Këtu shkolla nuk qëndroi shumë me që ishte e amortizuar dhe e pa përshtatshme.

Mejtepi i xhamisë së lagjes Perash, u

kthye në shkollë laike në vitin 1924, ku u emërua mësues laik Hasan Haveriku.

Mejtepi i xhamisë së lagjes Rus i Vogël, i ndërtuar nga Ali Kraja, banor i lagjes për bamirësi, për të mësuar fëmijët mësim fetare. Në vitin 1921 u kthye në shkollë laike dhe mori emrin: “Shkolla Hadrej”, ku vazhduan mësimet për shumë vite. Ndërtesa ka qenë dy katëshe me dhoma poshtë e lartë.

Mejtepi i xhamisë së lagjes Rus-Maxhar, i cili në vitin 1921 u kthye në shkollë laike. Më parë si mejtep u bë i njohur, kur e drejtoi Hafiz Muhamed Kali. Ky Hafiz kujdesej shumë vite me radhë. Ai qe dakord menjëherë të kalonte mejtepin në shkollë dhe u emërua mësues besimi. Në këtë mejtep



(shkollë), siç më ka treguar Hafiz Myrto Mani, karakteristikë është fakti se këtu zhvilloheshin veprimtari sportive, si ndeshje futbollit ndërmjet fëmijëve të lagjeve të qytetit.

Mejtepi i xhamisë së lagjes Ndocej u kthye në shkollë së bashku me xhaminë në vitin 1925. Mejtepi ka qenë ndërtuar nga e ama e Mustafa Pashës për bamirësi. Ndërtesa ka qenë një katëshe me përmasa 6x5x3, me 3-4 këmbë shkallë.

Mejtepi i xhamisë së lagjes Dudas, ku dha mësim Hafiz Ali Ulqinaku u bë i njohur në kohën e tij. U kthye në shkollë femërore laike në vitin 1933. Ndërtesa edhe sot është në pronësi të Myftinisë Shkodër, por shfrytëzohet për kopsht.

Paralel me hapjen e shkollave laike në mejtepet e qytetit, filluan të hapen shkollat në mejtepet e fshatit.

Mejtepi i xhamisë të fshatit Oblikë. Hapet shkolla laike 1917-1918 në mejtepin e xhamisë të fshatit Oblikë, i ndërtuar nga fisi i Shahinëve, banorë të fshatit. Për një kohë u mbyll për shkak të amortizimit dhe të riparimit, për tu hapur përsëri në vitin 1922, me iniciativën e imamit të xhamisë dhe njëkohësisht

kryeplak i fshatit. Hapjen e shkollës në këtë mejtep e bazojmë në kërkesën e parisë së fshatit, që ia përcjellë I.A.Sh. e cila e analizon dhe ia përcjell M.A. Tiranë nëpërmjet inspektorit të asaj kohe, Ismail Anamali, ku i shkruan: “Këtu ngjitur po kemi nderin tu paraqesim lutjen e katundit Oblikë, i liruar tash vonë me të cilin kërkojnë të hapunit e një shkolle në katundin e vet, meqenëse ndërtesa është gati, orenditë shkollore po i ndreq katundi vet, shohim të mundun të çelunit e një shkolle në këtë vend. Po qe se pëlqehet nga P.T. inspektoria e Përgjithshme, si mësues gjuhe për këtë shkollë propozojmë Z. Hamdi Gogaj, e mësues besimi Molla Hasan Dardha”. Mejtepi qe një ndërtesë e vogël, përdhese, një katësh me një dhomë 7x4, me dritare të vogla, që binin nga kodra, e amortizuar shumë nga koha e gjatë e ndërtimit. (M.H.Sh. viti 1921-22 me shkresë l501/2 dt.23/12/1921 e inspektorisë së arsimit Shkodër.

Mejtepi i xhamisë së fshatit Zogaj, u kthye në shkollë laike në vitin 1924. Ndërtesa ka qenë afër xhamisë. Ndërtesa ka qenë e vogël 7x5. Këtu më parë ishte imam i xhamisë dhe mësues besimi, Molla Alush Zaganjori, i cili e përkrahi hapjen e shkollës në mejtep dhe emërohet përsëri mësues besimi. Molla Alushi kreu edhe një kurs kualifikimi dhe u bë mësues i dytë. (A.Q.SH.SH. viti 1925.d.37 dhe vepra e cituar f.353).

Mejtepi i xhamisë së fshatit Zues, në vitin 1920-1921 hapet shkolla laike. Këtu u emërua mësues laik imami i xhamisë, Ali Rama dhe mësues besimi Hafiz Ymer Zaganjori. Mejtepi është ndërtuar rreth vitit 1905, në një kodër pranë xhamisë. Mejtepi ka qenë një dhomë, në kodër pranë xhamisë së fshatit, i cili zinte afro 40 fëmijë dhe i përmbushte normat e vijueshmërisë së mësimave.

Mejtepi i xhamisë së fshatit Mjedë, qe planifikuar të kthehet në shkollë laike, por për shkak të dëmtimit të rëndë nga ushtria serbo-malazeze, në vitin 1912-1913 dhe fshati nuk arriti ta rindërtojë. Për hapjen e shkollës ishte dakord dhe imami i xhamisë, Hafiz Asllani.

Mejtepi i xhamisë së fshatit Guri Zi, u kthye në shkollë laike me pëlqimin e mësuesit laik dhe të imamit të xhamisë së fshatit.

Mejtepi i xhamisë Vukatan, ishte planifikuar për shkollë laike, ku ishte

dakord dhe imami i xhamisë, por për arsye të ndryshme nuk u hap deri mbas çlirimit. Ndërtesa ka qenë me dy dhoma 5x6, me 5-6 këmbë shkallë pranë xhamisë, i cili ka qenë ndërtuar 250 vjet më parë.

Mejtepi i xhamisë së fshatit Trush u planifikua të kthehet në shkollë laike, në vitin 1921, por për arsye të ndryshme nuk u arrit të hapet.

Mejtepi i xhamisë së fshatit Boks, është kthyer në shkollë laike, në vitin 1923 me iniciativën e Adem Haxhisë, meqë aty ishte qendra e krahinës. Mejtepi ka qene 6x5, i ulët dhe përdhese, siç e përshkruan Hashim Kopliku, mësues i fshatit Mes-Myselim, në revistën Cirka.

Mejtepi i xhamisë së fshatit Dragoç, u kthye në shkollë laike në vitin 1938. Ndërtesa e mejtepit ka qenë me nga një dhomë poshtë e lart, 6x5x6 me shkalla brenda, e ndërtuar në vitin 1905 nga Fac Bajrami, banor i fshatit, për bamirësi.

Ka mejtepe të cilët janë kthyer në shkollë edhe mbas çlirimit të vendit.

Kontributi i institucioneve fetare dhe i hoxhallarëve mësues u ndie kudo, si në shkollat fetare dhe laike. Kontribut dhanë edhe myftinitë, të cilat lejonin dhe ishin dakord që shkollat e tyre, krahas asaj shpirtërore e fetare, të mësohet edhe kultura e përgjithshme.

Në këto shkolla Myftinia në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, hartonin programe dhe emëronin hoxhallarë mësues ndër më të aftit.

Hoxhallarët mësues që dhanë mësim besimi në shkollat laike shtetërore kanë qenë: Hafiz Veli Kruja në shkollën e lagjes Bahçallëk, Hafiz Jakup Çoba në shkollën femërore Ajasëm, Molla Fasli Zylja në shkollën e lagjes Parrucë, Hafiz Muhamed Kali në shkollën Rus-Maxhar, Hafiz Idriz Boksi në shkollën e lagjes Ndocaj, Molla Alush Zaganjori në shkollën e fshatit Zogaj, Ali Rama në shkollën Zues, Molla Idriz Kraja në shkollën Kader-Bales, Molla Zenel Ulqinaku në shkollën Drishtë. Meqë ky hoxhë kishte kryer edhe shkollën normale emërohet nga D.A.SH, mësues laik e fetar. Molla Hasan Dardha në shkollën e fshatit Oblikë, Hafiz Abdullah Bërdica në shkollën Rus-Maxhar, Hafiz Xhevdet Zylja, Hysejn Ef. Vuthi ishte drejtor i shkollës Rus-Haslikaj, dhe mësues besimi në këtë shkollë dhe ndër të tjera Hafiz Rexhep Zylyftari dha mësim fetare në shkollën popullore e hapur ne lagjen Rus i Vogël. Ky Hafiz ishte i pari që u aktivizua në shkollat laike, si dhe rrogën e kishte më të madhe, me 80 fr. shqiptare.

Molla Medoja me të vëllanë Salon në shkollën e Rusit të madh te xhamia Plakë që u hap në 1916 në mejtepin që qëndronte.

Në shkollën e Parrucës, drejtor shkolle qe Hafiz Abaz Golemi, i cili dha edhe mësim besim. Në këtë shkollë dha mësim besimi Hafiz Halil Puka. Sheh Ahmet Shkodra etj.

Hafiz Hati, i cili përveç ngarkimit të tij për hapjen e shkollës femërore në Rus të Madh emërohet mësues besimi. Hafiz Sali Zalefi emërohet mësues besimi në shkollën e lagjes Liria. Hafiz Veli Kruja emërohet mësues besimi në shkollën e lagjes Bahçallëk. Hafiz Sala Tophana emërohet mësues besimi në shkollën e lagjes Tophanë. Hafiz Muhamet Kastrati në shkollën e Rusit të Vogël. Në shkollën e Rus-Maxhar emërohet mësues besimi, Muhamet Kalaj. Hafiz Isa Anamali emërohet mësues besimi në shkollën “Oso Kuka” në lagjen Dudas. Hafiz Hajdar Sulejman Durrësi emërohet mësues në shkollën laike “Malet Tona” të hapur në vitin 1917.

Në shkollën Oso Kuka në lagjen Dudas janë emëruar mësues besimi: Molla Saiti, Hafiz Ismail Durrësi. Ky Hafiz dha mësim besimi edhe në shkollën femërore të Dudasit, e hapur në vitin 1925. Në shkollën femërore në lagjen Ajasëm emërohet mësues dhe njëheri është dakord që mësimet, shkolla t'i fillojë në shtëpinë e tij, meqë mejtepi ishte i papërshtatshëm. Në shkollën mashkullore laike në lagjen Ajasëm është emëruar mësues besimi Hafiz Jakup Çoba dhe Hafiz Muhamet Ulqinaku, Hafiz Sheuqet Boriçi dha mësim besimi në shkollën e lagjes Perash. Në këtë shkollë dha mësim edhe Hafiz Myrto Zaja. Në shkollën laike të hapur në lagjen Perash, ku qe mësues Hasan Tahsini (Haveriku) u emërua mësues besimi Hafiz Zenel Simoni. Në shkollën e fshatit Oblikë emërohet mësues besimi Ymer Ali Osmani dhe Hasan Darsha. Në shkollën e fshatit Zogaj emërohet mësues Molla Alush Zaganjori. Në shkollën e fshatit Mjedë emërohet mësues besimi Hafiz Asllan Osmani.

Në shkollën e Barbullushit emërohet në vitin 1929 mësues besimi Hafiz Ymer Zaganjori dhe më vonë Hafiz Rexhep Berdica. Në shkollën fillore në fshatin Drisht, qe emëruar mësues laik e besimi, Molla Zenel Ulqinaku. Në shkollën Kodër-Boks u emërua mësues besimi. Molla Rexhep Kraja, që në hapjen e saj në vitin 1925. Ka edhe hoxhallarë mësues që kanë dhënë mësim besimi, si Hafiz Muhamet Bekteshi me Hafiz Esat Myftia etj.



DUHET MEDOEMOS TË KETË NJË RIZGJIM..!

“Sa shumë kemi nevojë ne muslimanët të kuptojmë si duhet fenë tonë, pas asaj që dëshmuam, prej akuzave devijuese ndaj nesh me ekstremizëm dhe terrorizëm, si rezultat i kompleteve të armiqve të ymetit, keqkuptimit tonë të vlerave tona dhe moslartësimit të udhëheqësve dhe dijetarëve tanë në gradën e bartjes së amanetit! Arabët dhe muslimanët mbetën pas popujve të tjerë, prandaj duhet medoemos të ketë një rizgjim intelektual, rilindje ekonomike dhe mbrojtje të fisnikërisë njerëzore të popujve mbarë, për të qenë të gjithë, dorë për dorë drejt një të ardhmeje premtuese më të mirë!”

Dr. Salahudin A. Keftaro

MYFTIU TAKOI IMAMËT MBI LIGJËRIMIN DHE HARMONINË E JETËS FETARE

Paraditën e së enjtes, më 13 shtator 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e Myftinisë Shkodër.

Në qendër të takimit ishte analiza e vitit 1439, si dhe disa çështje që lidhen me cilësinë e ligjërimit, urtësinë e tij, si dhe nderin e shërbimit për përhapjen kudo të fesë së All-llahut, mësimave të Kur'anit dhe traditave të Hz. Muhamedit (a.s.).

Myftiu dha edhe disa udhëzime që kanë të bëjnë me detyrat dhe shërbimet e imamit, muezinit dhe mirëfunksionimin e jetës fetare në xhami.

U theksua se duhet angazhim i madh në drejtim të edukimit të brezit të ri me frymën e besimit islam, sikurse duhet që imamët të punojnë me të gjitha mundësitë për të qenë sa më afër rinisë



dhe xhematit të xhamive tona.

Myftiu tha se kjo është kohë sprovash të gjithanshme që kanë përfshirë vendin dhe mbarë ymetin islam,

sikurse po shtohen provokimet banale ndaj muslimanëve, si të ishin pakicë e diskretituar, prandaj ligjëruesit islamë duhet të jenë të vëmendshëm duke mos u stepur në punën dhe thirrjen e tyre.

BASHKËBISEDIM RRETH LIBRIT: “VATËR E DIJES SHKODRANE”

Pasditën e së xhumasë, më 14 shtator 2018, në ambientet e bibliotekës së qytetit, Myftinia Shkodër, me rastin e vitit të ri Hixhri 1440 dhe fillimit të vitit të ri shkollor 2018-2019, organizoi aktivitetin me temë: Bashkëbisedim rreth librit: “Vatër e dijes shkodrane”, me autor studiuesin z. Fiqiret Hoxha.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, drejtori i Medresesë së Shkodrës, z. Kujtim Dervishi, imamë, pedagogë, intelektualë dhe besimtarë shkodranë.

Pas hapjes së aktivitetit nga teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, fjalën e mori teologu Arben Halluni, përgjegjës i arsimit pranë Myftinisë Shkodër. Ai foli për vlerën dhe mirësinë e diturisë në Islam dhe rolin e rëndësishëm dhe parësor që dijetarët kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin në fushën e fesë. Teologu Halluni theksoi, se dituria për muslimanin është e para dhe pa të nuk arrihet asgjë, madje nëse duam të përparojmë, atëherë duhet të arsimohemi dhe të mos ndalemi asnjëherë nga kërkimi i diturisë.

Më pas foli studiuesi Fiqiret Hoxha, autori i librit “Vatër e dije shkodrane”, i cili hodhi dritë mbi kontributin



e intelektualëve dhe hoxhallarëve muslimanë në ngritjen dhe zhvillimin e arsimit në Shkodër. Ndër emrat e shumtë në këtë fushë, ai veçoi Hafiz Abaz Golemin, njëkohësisht themeluesi dhe drejtori i parë i shkollës së Parrucës. Ai theksoi, se falë përkushtimit dhe profesionalizmit të tij, shkolla e Parrucës përparoi dhe pati sukses në rrugëtimin e saj.

Një fjalë përhëndetëse mbajti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed

Sytari, i cili falënderoi autorin e librit, z. Fiqiret Hoxha për punën e tij të palodhur në evidentimin njerëzve të dijes, të cilët me përkushtim punuan për edukimin dhe arsimimin e brezit të ri.

Gjithashtu Imam Sytari uroi të pranishmit me rastin e vitit të ri Hixhri 1440 dhe njëkohësisht fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019.

Në fund të këtij aktiviteti me vlerë, përhëndetën drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi, prof. Bajram Xhafa, etj.

Karën Vog, bashkëpunëtore shkencore në degën e Historisë së Feve në Universitetin e Oslos, deklaroi se numri i muslimanëve në Norvegji vitet e fundit ka arritur në 3.000.

Sipas lajmit të botuar në gazetën me tirazhin më të madh të vendit, “Verdens Gand”, që nga vitet 1990 vihet re një rritje e numrit të norvegjezëve që preferojnë të kalojnë në fenë islame.

Gazeta përcjell deklaratat e Karën Vog, e cila thotë se numri i norvegjezëve muslimanë në vitet 1990 ishte 500, kurse në vitet e fundit shifra ka arritur në 3 mijë.

Në të kaluarën gratë norvegjeze e zgjidhnin fenë islame përmes martesës, cilëson Vog, ndërsa shton: “Tani ky fenomen ka ndryshuar shumë. Tani, veçanërisht gratë e përzgjedhin Islamin duke lexuar e bërë kërkime”.

Kurse Linda Noor, drejtore e Minotek Anthropogji, tha se bota po zvogëlohet dhe se të gjithë mund të kenë kudo qasje në informacionet rreth Islamit.

Monika Salmouk, një norvegjeze që është bërë muslimane 4 vite më parë,

ARRIN NË 3.000 NUMRI I NORVEGJEZËVE MYSLIMANË



tregon se ka bërë shumë kërkime dhe po lexonte libra mbi Islamin.

Norvegjezja Silje Aaliya Nilsen tha se atë e kishte tërhequr Islami dhe ishte bërë muslimane në moshën 16 vjeç.

42-vjeçarja Solva Nabila Sexelin gjithashtu tha se familja ishte kujdesur për familjet e azilkërkuesve dhe e kishte

zgjedhur Islamin duke u frymëzuar nga fëmijët e familjeve të emigrantëve muslimanë.

Ndërsa 77-vjeçari Truls Noor Ahmad Bolstad, një prej burrave norvegjezë që ka zgjedhur Islamin, thotë se ai është bërë muslimanë kur ka qenë 15 vjeç.

(www.radiojehona.al)

SHQIPTARËT KONTRIBUJNË PËR NDËRTIMIN E NJË XHAMIE NË GJERMANI

Kohëve të fundit, është vënë re një rritje interesi dhe dëshire nga të gjithë banorët e zonës përreth në qytetin e Troisdorfit të Gjermanisë, për të pasur një xhami e cila do t'i lejonte besimtarët muslimanë të praktikonin ritet e tyre fetare. Pikërisht në Republikën Nord Rhein Wesfalen do të ndërtohet një xhami e re, e cila do të zërë një hapësirë prej 930 metrash.

Mjaft pozitiv dhe shpresëdhënës duket fakti se kjo nismë vjen si një iniciativë e vetë shqiptarëve. Kjo xhami do të ndërtohet vetëm me kontributin e shqiptarëve në Gjermani. Nuk është i pakët numri i shqiptarëve në atë zonë, ku 600 familje shqiptare jetojnë në Troisdorf dhe në zonat përreth tij. Ndërtimi i kësaj xhamie parashikohet të zgjasë 2 vjet.

Plani arkitekturor i xhamisë nuk përfshin vetëm sallën e faljes. Krahas kryerjes së riteve fetare, kjo xhami do të shërbejë edhe si një qendër islame ku besimtarët do të mund të marrin dije. Plani do të përfshijë edhe salla konferencash, klasa mësimi etj.

Resmi Likaj, imami i kësaj xhamie



dhe njëkohësisht anëtar i bordit drejtues të Bashkësive Islame Shqiptare në Gjermani, mjaft entuziast, shprehet se ndjehet tejet i lumtur dhe krenar për punën që po bëhet nga shqiptarët muslimanë në Gjermani për mbrojtjen e identitetit fetar dhe kombëtar.

Mahir Mustafa, kryetari i këshillit të xhamisë, i cili jeton dhe punon mbi 25 vite në Gjermani, ndihet gjithashtu

i emocionuar nga atmosfera e fillimit të ndërtimit të kësaj qendre. Ai falënderon përzemërsisht të gjithë shqiptarët e Gjermanisë për përkrahjen që kanë dhënë dhe që vijojnë të japin.

Kjo qendër, gurthemeli i së cilës do të hidhet me datë 29.09.2018, do të marrë emrin “Ebu Hanife”, dijetarit të madh të ymetit islam.

Arabia Saudite ka përfunduar hekurudhën me një shpejtësi të madhe që lidh dy qytetet e shenjta islame, Mekën me Medinën. Kjo u bë në përpjekje për të përmirësuar bllokimin e trafikut për miliona pelegrinë myslimanë që vizitojnë vendin çdo vit, raporton Al Jazeera.

Mbreti Selman ka lançuar 450 kilometrat e hekurudhës me shpejtësi të lartë "Haramajn" që lidh dy qytetet nëpërmjet qytetit Xhidde në Detin e Kuq.

Sistemi hekurudhor, i cili ka 35 trena të aftë për të udhëtuar me shpejtësi prej 300 km në orë, gjithashtu do të transportojë udhëtarët e rregullt duke shkurtuar kohën e udhëtimit midis qyteteve të shenjta nga më shumë se pesë orë në dy orë.

Mbretëria po rrit shpenzimet e saj infrastrukturore dhe po zgjeron hekurudhat e saj duke përfshirë një sistem metro prej 22.5 miliardë dollarë që është në ndërtim e sipër në kryeqytetin Rijad, pasi ai kërkon të pavarësojë

ARABIA SAUDITE HAP HEKURUDHËN MË TË SHPEJTË QË LIDH MEKËN ME MEDINËN



ekonominë e saj të varur nga nafta. Lajmi për përfundimin e kësaj hekurudhe gëzon pa masë krejt dashamirët e Mbretërisë

Saudite, në veçanti haxhilerët dhe vizitorët e ardhshëm të vendeve të shenjta. - (www.radiojehona.al)

NUK HOQI DORË NGA ËNDRRA E SAJ, BËHET SPIKERJA E PARË ME MBULESË NË SHBA

Gazetarja në kanalin televiziv lokal WHBF në SHBA, Tahera Rahman, pavarësisht vështirësive ka fituar betejën duke u bërë spikerja e parë lajmeve e mbuluar me shami në SHBA.

Tahera, e cila punon në kanalin WHBF që kryen transmetime në rajonet Illinois dhe Iowa të SHBA-ve, duke folur për Anadolu Agency (AA), tha se historia e saj ka nisur në të vërtetë pas sulmeve të 11 shtatorit.

"Edhe unë ashtu sikurse i gjithë komuniteti musliman më 11 shtator jam shokuar për shkak të tragjedisë së përjetuar. Muslimanët përnjëherësh filluan të shikoheshin si armiq. Kam lindur dhe jam rritur në SHBA, por edhe komshinjtë na vërenin me dyshime. Në atë moment vendosa që të bëja diçka për të ndryshuar perceptimin e formuar ndaj muslimanëve", u shpreh Tahera.

Ajo ka shpjeguar se ka zgjedhur profesionin e gazetares për shkak se është një profesion që ka fuqinë që t'i shpjegojë të gjithë botës historitë e njerëzve, dhe se për të arritur profesionin ëndërr të saj ajo ka përfunduar studimet për gazetari në Universitetin Chicago Loyola, me mbështetjen e nënës së saj me origjinë indiane dhe të babait me origjinë pakistaneze.

Ajo tregon se iu ka dhënë përgjigjen



"jo" atyre të cilëve gjatë periudhës së arsimit dhe trajnimit e pyesnin "nëse do ta heqë apo jo mbulesën për të arritur punën që ëndërronte". Tahera është shprehur më tej se "Shumë njerëz më shprehnin se duhej të përgatitesha që të dëgjoja shumë herë përgjigjen e 'refuzimit'. Dhe kjo që ata më kanë shprehur më ka ndodhur, sepse kam marrë përgjigje refuzimi për dhjetëra aplikime që kam kryer".

"Pas dy aplikimeve të para pronarëve iu kam shkruar e-maile, ku i kam pyetur se çfarë duhet të bëj, dhe se si mund të bëhem një kandidate më e mirë për punën që dëshiroja. Në këtë mënyrë kam

filluar të punoj më fort dhe në aplikimin e tretë e fitova punën", ka theksuar Tahera.

Ajo shton se pasi e kishte kuptuar që për shkak të shamisë nuk do të mund të gjente një punë si gazetare në media fillimisht filloi punë në WHBF pas kamerave si "prodhuese e lajmeve" duke punuar në këtë pozicion për dy vite dhe duke mos hequr dorë nga ëndrra për t'u bërë spikere.

Tahera po ashtu ka shpjeguar se për herë të parë në ekran ka dalë më 8 shkurt dhe se ka marrë reagime pozitive nga çdo shtresë nga e gjithë bota duke përfshirë edhe nga Turqia.

(www.radiojehona.al)

"TË MËSOJMË DHE TË ARGËTOHEMI"

Ditën e shtunë, më 29 shtator, Myftinia Shkodër zhvilloi projekt-programin: "Të mësojmë dhe të argëtohem" në xhaminë e fshatit Gur i Zi. Përveç nxënësve pjesëmarrjes të kursit fetar të fshatit Gur i Zi, morën pjesë edhe nxënësit e xhamisë së fshatit Vukatanë, të shoqëruar nga mësuesit e tyre, respektivisht Ritvan Frexhaj dhe Adil Cukali.

Përgjegjësi i arsimit, pranë myftinisë, teologu Arben Halluni, gjatë prezantimit të aktivitetit, mbajti një bisedë këshilluese me nxënësit, duke vu theksin për besim të drejtë e të përkushtuar, për moral e sjellje



shembullore në familje dhe në komunitetin. Teologu Halluni theksoi, se besimtari mysliman sa më i dobishëm të jetë për shoqërinë, aq më dashur është edhe tek Allahu (xh.sh).

Më pas u zhvillua një konkurs fetar, në bazë të njohurive që nxënësit marrin nga mësimet e mejtepeve. Gjithashtu u shpërndanë dhurata të ndryshme, si dhe u organizuan lojëra sportive dhe argëtuese mes nxënësve të dy xhamive, Gur i Zi dhe Vukatanë.

Një projekt i tillë arsimor dhe argëtues do të mbahet në të ardhmen edhe në xhamitë e tjera të Myftinisë Shkodër.






**"Kur All-llahu urdhëron
për diçka,
ti mos u frikëso!**

**AI DO TË NDIHMOJË TA
ARRISH ATË!**

**E keqja është,
kur nuk e kupton
urdhërin e All-llahut,
ashtu siç do Ai.**

**ATËHERË MENDO
PASOJAT...!"**



Sheikh Ahmed Rëstari

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org